



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 161

Tiranë – E martë, 15 shtator 2015

PËRMBAJTJA

Vendim i Gjykatës së Lartë
nr. 3, datë 28.4.2014

Objekti i padisë: Detyrimin e të paditurit, Gjok Shota, të më kthejë dhe të posedoj lirish: a) pasurinë me nr. 80/6 në zonë kadastrale 1185, tokë arë me sipërfaqe 8445 m² me këto kufizime: V-80/5, L-80/7, P-143, e ndodhur në fshatin Bilaj, Komuna Bubq, në pronësi të paditëses Marjana Përnuca.....

Faqe

11349



VENDIM
Nr. 3, datë 28.4.2014

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbëra nga:

Xhezair Zaganjori	kryesues
Ardian Nuni	anëtar
Ardian Dvorani	anëtar
Arjana Fullani	anëtare
Evelina Qirjako	anëtare
Aleksandër Muskaj	anëtar
Guxim Zenelaj	anëtar
Edmond Islamaj	anëtar
Mirela Fana	anëtare
Medi Bici	anëtar
Shkëlzen Selimi	anëtar
Artan Zeneli	anëtar
Admir Thanza	anëtar
Tom Ndreca	anëtar
Artan Broci	anëtar,

Në seancën gjyqësore publike, të datës 4.4.2014 dhe 28.4.2014, morën në shqyrtim çështjen administrative nr. 00817-2014 akti, që u përket palëve:

PADITËSE E K/PADITUR: Marjana Përnuca.

I PADITUR K/PADITËS: Gjok Shota.

TË PADITUR NË K/PADI: Komisioni

Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Durrës.

Xhentil Kupe.

PERSON I TRETË NË PADI DHE K/PADI: Komuna Bubq.

PERSON I TRETË NË K/PADI: Zyra

Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Krujë.

OBJEKTI I PADISË: *Detyrimin e të paditurit, Gjok Shota, të më kthejë dhe të posedoj lirisht: a) pasurinë me nr. 80/6 në zonë kadastrale 1185, tokë arë me sipërfaqe 8445 m² me këto kufizime: V-80/5, L-80/7, P-143, e ndodhur në fshatin Bilaj, Komuna Bubq, në pronësi të paditëses Marjana Përnuca.*

BAZA LIGJORE E PADISË: *Neni 296 i Kodit Civil, neni 31 dhe 32 i Kodit të Procedurës Civile, vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë, me nr. 5, datë 31.5.2011.*

OBJEKTI I K/PADISË: *Pavlefshmërinë e aktit të marrjes së tokës në pronësi nr. 223, me sipërfaqe 10 000 m² në emër të të paditurve, pasuria 80/20 në ZK 1185, sipas certifikatës për vërtetim pronësie nr. 473, datë 5.2.2010, kthimin e pasurisë në gjendjen e mëparshme.*

Fshirjen e pasurisë nr. 80/20 nga kartela e pasurive dhe harta treguese nga emri i Marjana Përnuca dhe Xhentil Kupe.

BAZA LIGJORE E K/PADISË: *Ligji nr. 9948, datë 7.7.2008, ligji 7501, datë 19.7.1991, vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 230, datë 23.7.1991, vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 255, datë 2.8.1991, udhëzimi nr. 2, datë 2.8.1991 etj.*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin nr. 36, datë 5.2.2014, ka vendosur:

Shpalljen e moskompetencës në lidhje me çështjen civile nr. 37/278 akti, datë 16.1.2013 regjistrimi.

Dërgimin e akteve Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, së cilës i përket edhe kompetenca në lidhje me këtë çështje.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, me vendimin e seancës përgatitore të datës 26.2.2014, ka vendosur:

Të ngrejë çështjen e mosmarrëveshjes për kompetencë para Gjykatës së Lartë në gjykimin e çështjes administrative, me nr. 2398: me palë paditëse: Marjana Ded Përnuca; me palë të paditur: Gjok Shota; person i tretë, Komuna Bubq, me objekt: Detyrimin e të paditurit Gjok Shota të më kthejë dhe të posedoj lirisht: a) pasurinë me nr. 80/6 në zonë kadastrale 1185, tokë arë, me sipërfaqe 8445 m² me këto kufizime: V-80/5, L-80/7, P-143, e ndodhur në fshatin Bilaj, Komuna Bubq, në pronësi të paditëses Marjana Përnuca.

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, pasi mori në shqyrtim çështjen, konstaton se kërkimet në padi kanë të bëjnë me mosmarrëveshje të së drejtës civile, ndërsa kërkimet në kundërpadi kanë të bëjnë me fushën e së drejtës administrative. Duke u mbështetur në interpretimet unifikuese të vendimit nr. 3, datë 6.12.2013 dhe nr. 4, datë 10.12.2013, vendimit nr. 2, datë 10.3.2014, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nisur dhe nga parimi se një gjykatë është kompetente për gjykimin e shumë kërkimeve, atëherë, kur këto kërkime janë në kompetencën lëndore të saj, Kolegji Administrativ çmoi se çështja konkrete duhet kaluar në Kolegjet e Bashkuara. Në këtë drejtim, Kolegji Administrativ vlerësoi se për zgjidhjen e çështjes, duhen vënë në diskutim çështje të tilla si: në vijim të interpretimit unifikues të vendimit nr. 4, datë 10.12.2013, të Gjykatës së Lartë, kërkimet e parashtruara para një gjykate, kur i përkasin kompetencës lëndore



të gjykatave të ndryshme, duhen gjykuar në mënyrë të ndarë nga njëra-tjetra apo së bashku dhe në këtë rast, cila gjykatë është kompetente lidhur me gjykimin e këtyre kërtimeve?

Një diskutim i tillë bëhet për shkak të hyrjes në fuqi të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, përcaktimit të qartë prej tij të çështjeve që do të gjykohen nga gjykatat administrative dhe të shfuqizimit të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, që kishin të bënin me gjykimin administrativ. Në këtë drejtim, janë konstatuar probleme në praktikën gjyqësore të gjykatave administrative dhe civile, në drejtim të përcaktimit prej tyre të gjykatës kompetente që do të shqyrtonte kundërpandinë e një natyre të ndryshme nga padia.

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke marrë shkas nga çështja në shqyrtim, raste të paraqitura për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, me qëllim shmangien e qëndrimeve të ndryshme në mes gjykatave, por edhe vetë kolegjeve të ndryshme të Gjykatës së Lartë, çmon se çështja duhet të dërgohet në Kolegjet e Bashkuara, të cilat të njësojnë qëndrimet në lidhje me çështjet e mëposhtme:

1. Nëse në një gjykim civil paraqitet një kundërpadi e natyrës administrative ose e kundërta (në një gjykim administrativ paraqitet një padi e natyrës civile), si do të veprojnë gjykata në lidhje me kompetencën lëndore për shqyrtimin e këtyre kërtimeve?

2. Si do të veprohet në lidhje me kompetencën lëndore në gjykimin në shkallën të parë, në apel dhe në Gjykatë e Lartë, për çështjet në të cilat kundërpadia është paraqitur dhe është pranuar për t’u marrë në shqyrtim para datës 4.11.2013. Po në rastet kur kundërpadia është paraqitur para datës 4.11.2013, por gjykata ka pranuar të marrë (ose e merr) në shqyrtim kundërpandinë pas kësaj date?

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relatimin e çështjes nga gjyqtarët Xhezair Zaganjori dhe Shkëlzen Selimi, si dhe pasi diskutuan çështjen në tërësi,

VËREJNË:

Rrethanat e çështjes:

1. Të paditurit në kundërpadi, Xhentil Kupe, si kryefamiljar në familjen bujqësore të përbërë prej tij dhe paditëses, Marjana Përnuca (bashkëshortja), i është dhënë në pronësi 10 000 m² tokë arë, në fshatin Bilaj, në mbështetje të ligjit 7501, “Për tokën”.

2. Me anë të kontratës së shitblerjes nr. 88 rep, nr. 37/3 kol, datë 19.1.2008, i padituri në kundërpadi, Xhentil Kupe, i ka shitur bashkëshortes së tij, paditëses Marjana Përnuca, pjesën që i takonte në këtë pasuri, me sipërfaqe 8446 m². Më pas, me anë të kontratës nr. 231, datë 25.2.2010, paditësja i ka shitur një sipërfaqe prej 1000 m², shtetasit Tomor Cenka. Ndërkohë, sipërfaqja tjetër është zënë nga i padituri kundërpaditë, Gjok Shota.

3. Paditësja ka ngritur padi në gjykatë duke kërkuar lirimimin dhe dorëzimin e sipërfaqes së tokës së zënë në mënyrë të padrejtë nga i padituri kundërpaditë, Gjok Shota. Gjatë gjykimit, në muajin shtator të vitit 2013, i padituri Gjok Shota ka paraqitur një kundërpadi, në të cilën kundërshton aktin e cituar më sipër të marrjes së tokës në pronësi nga Xhentil Kupe dhe kthimin në gjendjen e mëparshme. Me paraqitjen e kundërpadisë, gjykata nuk është shprehur nëse e pranonte apo jo dhe ka vazhduar gjykimin. Më pas, gjyqtarja e çështjes është transferuar në një tjetër gjykatë dhe në këtë mënyrë çështja është hedhur përsëri në short. Gjyqtarja, e cila pas hedhjes së shortit duhet të gjykonte çështjen, në seancën përgatitore të datës 5.2.2014, me vendim të ndërmjetëm, ka vendosur të lejojë marrjen në shqyrtim të kundërpadisë. Pas këtij hapi procedural, nga ana e gjykatës është marrë në shqyrtim kompetenca lëndore e saj në shqyrtimin e çështjes, nisur nga vendimi unifikues nr. 3, datë 6.12.2013, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Pala paditëse ka kërkuar që kundërpadia të gjykohet në gjykatën administrative, duke qenë se akti i marrjes së tokës në pronësi nga Komuna Bubq, Qarku Durrës, është një akt administrativ i lëshuar nga njësitë e qeverisjes vendore. Pala e paditur kundërpaditëse nuk ka pasur ndonjë kundërshtim në lidhje me kompetencën e gjykatës që do të shqyrtonte kundërpandinë.



4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Krujë me vendimin nr. 36, datë 5.2.2014, ka vendosur të shpallë moskompetencën e saj në lidhje me këtë çështje dhe dërgimin e akteve, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, si gjykata kompetente në zgjidhjen e çështjes. Në vendimin e saj, gjykata ka arsyetuar se gjykimi i kundërpadisë ka natyrë administrative dhe objekti i kundërpadisë është primar në raport me objektin e padisë, prandaj kompetenca lëndore i takon gjykatës administrative.

5. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin e seancës përgatitore të datës 26.2.2014, ka vendosur të ngrejë çështjen e mosmarrëveshjes për kompetencë para Gjykatës së Lartë, duke arsyetuar se mosmarrëveshja në mes të palëve është e natyrës civile. Sipas kësaj gjykate, kërkimi i padisë lidhet me të drejta të pronësisë dhe pikërisht me padinë e rivendikimit të parashikuar nga neni 296 i Kodit Civil, padi e cila synon të prekë të drejta që lidhen me fushën civile. Sipas kësaj gjykate, duke iu referuar edhe frymës së interpretimit të vendimit nr. 4, datë 10.12.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, çështja duhet gjykuar nga gjykata civile.

Vlerësimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

I. Në lidhje me çështjen e parë të shtruar për unifikim

6. Çështja e parë që u shtrua për unifikim praktik nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ka të bëjë me faktin, nëse në një gjykim civil paraqitet një kundërpadi e natyrës administrative ose e kundërta (në një gjykim administrativ paraqitet një padi e natyrës civile), çfarë do të ketë parasysh dhe si do të veprojë gjykata në lidhje me kompetencën lëndore për shqyrtimin e këtyre kërtimeve të natyrave të ndryshme?

7. Për shqyrtimin e problemeve të mësipërme nga ana e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, çmohet e nevojshme të analizohet natyra e kërtimeve të kundërpadisë, kushtet e pranueshmërisë së saj, rregullimi ligjor në lidhje me gjykatën që do të shqyrtojë kundërpadinë etj.

8. Në vendimin unifikues nr. 901, datë 14.7.2000, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë trajtuar natyrën dhe dallimet në mes padisë dhe të kundërpadisë, si kërtime që

ngrihen më vete dhe që mund të shqyrtohen në gjykime të veçanta. Konkretisht, në këtë vendim, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë janë shprehur ndër të tjera se: “... kundërpadia është padi e të paditurit që drejtohet kundër paditësit, e paraqitur në një gjykim të filluar, deri sa nuk ka përfunduar hetimi gjyqësor. Që padia e të paditurit kundërpaditës të cilësohet si kundërpadi dhe të pranohet të gjykohet së bashku me padinë në gjykimin e filluar duhet të plotësojë të paktën njërin nga dy elementet substanciale të kërkuar nga neni 160/1, i Kodit të Procedurës Civile, lidhjen (koneksitetin) midis kërtimeve dhe/ose mundësinë e kompensimit (ndërshterjes) së detyrimeve të ndërsjella. Duke qenë se si padia edhe kundërpadia mund të trajtohen secila si padi më vete në gjykime të veçanta, sipas çmimit të gjykatës, kuptohet që kur gjykohen së bashku në një gjykim të vetëm, në vendimin përfundimtar, eventualisht mund të vendoset: a) Pranimi i padisë dhe i kundërpadisë, duke vendosur, kur është rasti, edhe kompensimin e detyrimeve të ndërsjella; b) Pranimin e padisë dhe rrëzimin e kundërpadisë; c) Rrëzimin e padisë dhe pranimin e kundërpadisë; ç) Rrëzimin e padisë dhe të kundërpadisë.”.

9. Nga sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se kundërpadia ka të bëjë me kërkimet e të paditurit në një gjykim të filluar, ku ai jo vetëm që kundërshton padinë duke kërkuar rrëzimin e saj, por ngre edhe kërtime të tjera, të cilat tejkalojnë objektin e padisë, duke pretenduar mbrojtjen e të drejtave të tij subjektive nëpërmjet gjykatës. Këto kërtime në kundërpadi kanë si qëllim nga njëra anë realizimin e mbrojtjes së të paditurit ndaj padisë, por nga ana tjetër ato parashtrojnë dhe pretendime që qëndrojnë më vete si padi e veçantë. Kundërpadia, duke qenë një mjet procedural mbrojtës, paraqitet gjatë gjykimit të një padie të iniciuar nga paditësi.

10. Kushtet për pranimin e marrjes në shqyrtim të kundërpadisë janë parashikuar në nenin 160/1 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit: “I padituri ka të drejtë të paraqesë kundërpadi kur kërkimi i kundërpadisë ka lidhje me atë të padisë ose kur midis tyre mund të bëhet kompensimi”. Në referim të dispozitës së mësipërme, vihet re se kushtet për paraqitjen e kundërpadisë dhe marrjen e saj në shqyrtim nga ana e gjykatës janë: së pari, pasja lidhje në mes të kërtimeve të padisë dhe të kundërpadisë ose së dyti, kompensimi në mes tyre.



11. Kriteri i parë për të pranuar marrjen në shqyrtim të një kundërpadie është pasja lidhje midis kërimit të kundërpadisë dhe atij në padi. Kërkimet e padisë dhe të kundërpadisë kanë lidhje me njëra-tjetrën, atëherë kur faktet që parashtrihen në kundërpadi kanë të bëjnë me po ato fakte të parashtruara në padi, ose edhe kur mbështeten në fakte të tjera të papërmendura në padi, por janë kërtime që varen nga njëri-tjetri në zgjidhjen e tyre. Lidhja midis padisë dhe kundërpadisë nuk duhet parë thjesht formalisht dhe në mënyrë të ngushtë, pasi kërkimet në padi dhe në kundërpadi mund të rrjedhin nga i njëjti titull ose jo, por mjafton që këto kërtime të kenë në themel të secilit të njëjtin raport juridik në mes tyre. E rëndësishme është që të ekzistojë një raport i tillë juridik, në të cilin të vihet në dukje lidhja objektive në mes të padisë dhe të kundërpadisë, raport i cili të jetë i drejtpërdrejtë dhe të bëjë të përshtatshëm dhe të nevojshëm gjykimin e njëkohshëm të këtyre dy kërtimeve në një proces të vetëm.¹

12. Kriteri i dytë alternativ që parashikon ligji, me qëllim që gjykata të pranojë marrjen për shqyrtim të një kundërpadie, është edhe kompensimi në mes të kërtimeve të padisë dhe kundërpadisë. Në këtë rast, kërkimet në kundërpadi mund të mos kenë lidhje me kërkimet në padi, mund të mos mbështeten në të njëjtat fakte mbi të cilat mbështet padia, madje mund të mos ketë lidhje me to. E rëndësishme është që këto kërtime në kundërpadi, të mund të kompensojnë kërkimet e parashtruara në padi.

13. Duke pasur parasysh natyrën juridike të kundërpadisë, si një kërkim i pavarur nga padia, por që paraqitet në të njëjtin gjykim për t'u shqyrtuar bashkë me padinë, mund të qëndrojë më vete dhe rrjedhimisht, mund të shqyrtohet më vete. Megjithatë, jo pa qëllim, ligji e ka parashikuar mundësinë, por jo detyrimin, e shqyrtimit të tyre së bashku në një proces të vetëm dhe të njëkohshëm (*simultaneus processus*). Qëllimi i ligjit në këtë drejtim ka qenë sigurimi i një mënyre efektive mbrojtjeje për të paditurin, që po në atë gjykim të filluar, jo vetëm të kundërshtojë padinë, por edhe të paraqesë kërtime ndaj paditësit. Po kështu, shqyrtimi së bashku i padisë dhe i kundërpadisë ka të bëjë me

shmangien e dhënies së disa vendimeve të ndryshme në lidhje me të njëjtën çështje, e po kështu ka të bëjë edhe me ekonominë gjyqësore për palët dhe dhënien zgjidhje të mosmarrëveshjeve në mes tyre.

14. Nga sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë të analizojnë problemin e kompetencës lëndore të gjykatave për shqyrtimin e tyre, kur këto kanë natyrë të ndryshme. Kështu, në lidhje me gjykatën kompetente për shqyrtimin e kundërpadisë të paraqitur në një gjykim të filluar për shqyrtimin e një padie, neni 55 i Kodit të Procedurës Civile ka përcaktuar se: *“Gjykata që shqyrton, gjykon padinë kryesore është kompetente për të shqyrtuar edhe kërkesat dytësore, kundërpadinë ose ndërhyrjen kryesore. Në këtë rast, gjykata merr vendim për bashkimin e tyre në një çështje të vetme”*.

15. Nenet 55 dhe 160 të Kodit të Procedurës Civile, të cilat janë rregullimi procedural në lidhje me padinë dhe kundërpadinë, nuk përcaktojnë kriteret mbi natyrën e kërtimeve që përcaktojnë gjykatën kompetente, e cila do të shqyrtojë kundërpadinë e paraqitur në një gjykim të filluar. Të vetmet kriteret të përmendura në këto dispozita janë kushti i lidhjes ose kompensimit me padinë. Në një interpretim formal të normave të mësipërme, në pamje të parë, normat e mësipërme lënë të kuptohet se gjykata bëhet kompetente për shqyrtimin e kundërpadisë për shkak se ka kompetencën për shqyrtimin e padisë dhe si pasojë e lidhjes në mes tyre. Kështu gjykata, edhe sikur të mos jetë kompetente nga pikëpamja lëndore për shqyrtimin e kundërpadisë, bëhet kompetente për shkak se ka kompetencën për shqyrtimin e padisë dhe si pasojë e lidhjes apo i kompensimit që kundërpadia ka me padinë.

16. Megjithatë, Kolegjet vërejnë se, pasi gjykata të vlerësojë nëse kërkimet në kundërpadi kanë ose jo lidhje me kundërpadinë dhe nëse kompensohen në mes tyre, duhet të verifikojë nëse është kompetente për ta gjykuar atë kundërpadi. Neni 41 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se: *“Në kompetencë të gjykatës së shkallës së parë janë të gjitha mosmarrëveshjet civile e mosmarrëveshjet e tjera të parashikuara në këtë Kod e në ligje të tjera”*. Në referim të kësaj dispozite, gjykata civile mund të marrë në shqyrtim vetëm çështjet që i janë lënë në kompetencën e saj nga Kodi i Procedurës Civile, e po kështu nga ligje të tjera të cilat bëjnë

¹ Qëndrim i mbajtur dhe në doktrinën e së drejtës procedurale italiane – Codice di Procedura Civile e Norme Complementari con il commento della giurisprudenza della Cassazione – Milano. Dott. A. Giuffrè Editore, f. 164, 165.



kompetente këtë gjykatë. Në interpretimin e kundërt të dispozitës së sipërcituar, gjykata civile nuk mund të shqyrtojë mosmarrëveshje që nuk janë në kompetencën lëndore të saj. Pra, pavarësisht se në Kodin e Procedurës Civile nuk thuhet konkretisht në ndonjë dispozitë konkrete, gjykata mund të shqyrtojë një kundërpadi vetëm nëse ka kompetencën lëndore për ta gjykuar atë.

17. Në ndryshim nga Kodi i Procedurës Civile në fuqi, ligji nr. 2625, datë 17.3.1958, “Mbi Kodin e Procedurës Civile të Republikës Popullore të Shqipërisë”, e kishte parashikuar shprehimisht që kundërpadia mund të shqyrtohej bashkë me padinë nëse i përkisnin kompetencës lëndore të së njëjtës gjykatë. Konkretisht, neni 37/1 i Kodit të Procedurës Civile, RPSH, parashikonte: *“Gjykata që shqyrton padinë kryesore është kompetente për të shqyrtuar edhe padinë aksesorë, kundërpadinë dhe ndërhyrjen kryesore. Për çështjet që janë në kompetencën e gjykatës së qarkut, sipas pikës 5, të nenit 22, të këtij Kodi, nuk mund të shqyrtohen nga gjykata popullore bashkë me padinë kryesore. Në këto raste, gjykata popullore ose mban dhe shqyrton vetë padinë kryesore, ose bashkë me çështjen tjetër ia dërgon për shqyrtim gjykatës kompetente të qarkut”*. Pra sipas kësaj dispozite, kundërpadia paraqitet në gjykatën në të cilën është në zhvillim e sipër procesi për shqyrtimin e padisë ndaj të paditurit. Por nëse për kërkesën e kundërpadisë ishte kompetente një gjykatë e llojit tjetër, rregullimi i sipërcituar nuk kishte vlerë. Në një rast të tillë, i padituri, për kërkesën e tij, duhej të kërkonte mbrojtjen juridike të së drejtës subjektive në gjykatën kompetente.

18. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, situata paraqitet ndryshe nga sa u analizua më sipër, pasi tashmë janë krijuar gjykatat administrative me kompetencë lëndore tërësisht të ndarë. Ky ligj rregullon në tërësi fushën e kompetencave të gjykatës administrative të krijuar me anë të këtij tij, parimet, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit, procedurën e gjykimit administrativ, ekzekutimin e vendimeve etj. Neni 7, i ligjit nr. 49/2012, ka përcaktuar rrethën e çështjeve që mund të gjykojë gjykata administrative, si vijon: *a) mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik; b) mosmarrëveshjet që lindin për shkak të ndërhyrjes së*

paligjshme ose të mosveprimit të organit publik; c) mosmarrëveshjet e kompetencave ndërmjet organeve të ndryshme administrative në rastet e parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative; ç) mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës, kur punëdhënësi është organ i administratës publike; d) kërkesat e paraqitura nga organet administrative për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative, për të cilat ligji parashikon heqjen e lirisë deri në 30 ditë, si një lloj të dënimit administrativ për kundërvajtësin; dh) kërkesat e paraqitura nga kundërvajtësit për zëvendësimin e dënimit administrativ me heqje lirie deri në 30 ditë me dënimin me gjobë”.

19. Ndërkohë, neni 8/2 i ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” parashikon se çfarë nuk mund të gjykojë kjo gjykatë, duke përcaktuar se: *“Gjykata administrative nuk shqyrton mosmarrëveshjet; b) shqyrtimi i të cilave, sipas legjislacionit në fuqi, është në kompetencën e një gjykate tjetër”*.

20. Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 49/2012, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin unifikues nr. 3, datë 6.12.2013, theksuan ndarjen përfundimtare për sa i përket kompetencës lëndore në mes të gjykatës civile dhe administrative. Ligji nr. 49/2012, ashtu si edhe Kodi i Procedurës Civile, nuk kanë ndonjë dispozitë që të trajtojnë problemin e kompetencës lëndore të gjykatës që duhet të shqyrtojë kundërpadinë, nëse kjo e fundit paraqitet në një proces gjyqësor gjatë shqyrtimit të padisë, por që ka natyrë të ndryshme prej saj. Kjo natyrë e ndryshme ndikon në faktin që nëse kërkimi i kundërpadisë do të paraqitet në një gjykim tjetër, të ndryshëm nga ai i padisë, nuk do të mund të shqyrtohej dot në të njëjtën gjykatën ku po shqyrtohet padia, për shkak të moskompetencës lëndore të gjykatës. Pra e thënë ndryshe, nëse kjo kundërpadi do të paraqitet veçmas nga padia në një tjetër gjykim, ajo nuk do të mund të merret në shqyrtim nga gjykata, për shkak se i mungon kompetenca lëndore.

21. Në këtë kuptim, është i nevojshëm një interpretim në tërësi i dispozitave të dy ligjeve që rregullojnë respektivisht veprimtarinë e gjykatave civile dhe atyre administrative, në drejtim të kompetencës lëndore në shqyrtimin e kërtimeve në padi dhe kundërpadi. Problemi që duhet analizuar është kuptimi dhe vlera në aktualitetin e sotëm juridik të nenit 55 të Kodit të Procedurës Civile.



22. Ligji nr. 49/2012, në mungesë të parashikimeve procedurale të hollësishme, ka rregulluar mënyrën e funksionimit të gjykatave administrative, parimet themelore, procedurën e gjykimit etj. Duke mos e rregulluar në hollësi çdo problem që i takon gjykimit, në këtë ligj është parashikuar mundësia e referimit në Kodin e Procedurës Civile për çështjet të cilat nuk janë rregulluar nga ligji nr. 49/2012, duke vënë kushtin e vetëm që ky rregullim i Kodit të Procedurës Civile të mos bjerë në kundërshtim me normat dhe parimet e ligjit nr. 49/2012. Konkreisht, në nenin 1, prg. 2 të tij, parashikohet se: *“Dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe”*. Në këto kushte, vetë ky ligj, për ato çështje të cilat nuk i ka parashikuar, ka lejuar referimin në Kodin e Procedurës Civile, për aq sa nuk bien ndesh me normat e vendosura nga ligji nr. 49/2012. Në këto kushte, shtrohet i nevojshëm interpretimi ligjor i zbatimit të nenit 55 të Kodit të Procedurës Civile në lidhje me ndarjen e kompetencës lëndore të gjykatës në atë civile dhe administrative. Pra, në kontekstin e ri ligjor natyrshëm lind pyetja se cili është kuptimi ligjor i nenit 55 në lidhje me zbatimin e tij nga të dy gjykatat, kur ka kërkime, siç janë paditë dhe kundërpaditë e natyrave të ndryshme.

23. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se neni 55 i Kodit të Procedurës Civile, përveçse duhet interpretuar jo në mënyrë formale, duhet parë edhe në kontekstin historik dhe në situatën ligjore në të cilën është miratuar. Vetë sistemi gjyqësor, përpara datës 4.11.2013, ndahej në gjykata civile dhe gjykata penale. Kodi i Procedurës Civile ka rregulluar në tërësi procedurën e gjykimit civil, i cili ishte i ndarë në seksione të posaçme si administrative, familjare etj. Është e vërtetë se gjykimet e posaçme, si p.sh., ato administrative ishin të rregulluara në mënyrë të veçantë nga gjykimet civile, por rregullat e gjykimit, të drejtat dhe detyrimet e palëve, parimet etj., mbeteshin të njëjtat për të gjitha këto gjykime. Pavarësisht se edhe para krijimit të gjykatave administrative ka pasur brenda të njëjtit gjykim kërkime të natyrës civile dhe të natyrës administrative, gjykata që shqyrtonte padinë, i ka marrë në shqyrtim edhe kërkimet e natyrës tjetër të parashtruara në kundërpadi, për shkak të parashikimit ligjor të nenit 55 të Kodit të Procedurës Civile. Ajo që duhet

theksuar është se bëhet fjalë për të njëjtin ligj procedural, i cili parashikonte të gjithë procesin gjyqësor civil, e po kështu edhe përjashtimet apo rregullimet specifike, përmes dispozitave të gjykimeve të posaçme. Vetë dispozitat e posaçme të Kodit të Procedurës Civile, në lidhje me gjykimet e seksioneve administrative, nuk përmbanin ndonjë rregullim specifik në kundërshtim me nenin 55 të Kodit të Procedurës Civile. Në themel të tyre, të gjitha këto gjykime kishin të njëjtin ligj me anë të të cilit gjykatat civile dhe seksionet e tyre, përfshirë edhe ato administrative, ushtronin aktin në drejtim të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

24. Tashmë, situata juridike ka ndryshuar, pasi me miratimin e ligjit nr. 49/2012, bëhet fjalë për dy gjykata tërësisht të ndryshme, me kompetenca të mirëpërcaktuara dhe të ndara lëndore, veprimtaria e të cilave rregullohet në mënyra të ndryshme. Këto dy gjykata, përfundimisht, janë të ndara si në lëndën e gjykimit, rregullimet ligjore që përcaktojnë procedurën e gjykimit të secilës, parimet etj. Në këtë kuptim, në drejtim të rrethit të mosmarrëveshjeve që këto gjykata do të zgjidhin, rregullimi ligjor i nenit 55 të Kodit të Procedurës Civile vihet në diskutim në kuadër të shqyrtimit të padisë dhe kundërpadisë me natyrë të ndryshme. Gjykatat mund të shqyrtojnë vetëm ato kërkime të palëve, të cilat ligji ia ka lënë në kompetencën e tyre. Në interpretim të kundërt të këtij përfundimi, kërkimet, të cilat shprehimisht ligji i ka përcaktuar në kompetencë të një gjykate, nuk mund t'i shqyrtojë një gjykatë tjetër, pavarësisht lidhjes apo kompensimit që këto kërkime mund të kenë me njëri-tjetrin. Kjo, për arsye se, ligji ia ka hequr të drejtën për të shqyrtuar të tilla kërkime (neni 8/2 i ligjit nr. 49/2012).

25. Për më tepër, neni 23 i ligjit nr. 49/2012 parashikon se: *“Në një kërkesëpadi mund të parashtrihen disa kërkime, në rast se gjykata është kompetente për të gjitha kërkimet ...”*. Të njëjtin rregullim e parashikon edhe neni 159 i Kodit të Procedurës Civile, kur shprehet se *“Në një kërkesëpadi mund të parashtrihen shumë kërkime, në rast se gjykata është kompetente për të gjitha kërkimet ...”*. Në interpretim të këtyre dispozitave, një gjykatë nuk mund të shqyrtojë të gjithë kërkimet e një padie nëse ligji nuk i ka dhënë asaj kompetencën lëndore për t'i gjykuar ato. Si rrjedhim, gjykata duhet të mbajë për shqyrtim vetëm ato kërkime të padisë për të cilat është kompetente.



26. Neni 8/2 i ligjit nr. 49/2012 (siç është përmendur në prg. 17) parashikon se çfarë nuk mund të shqyrtojë gjykata administrative, kur shprehet se gjykata administrative nuk shqyrton mosmarrëveshjet: b) shqyrtimi i të cilave, sipas legjislacionit në fuqi, është në kompetencën e një gjykate tjetër. Ndërkohë, sipas nenit 41 të Kodit të Procedurës Civile, gjykata civile ka të drejtë të shqyrtojë çdo mosmarrëveshje civile e mosmarrëveshjet e tjera të parashikuara në këtë Kod e në ligje të tjera. Pra, sipas këtyre rregullimeve ligjore gjykata administrative nuk mund të shqyrtojë mosmarrëveshjet që ligjet i kanë lënë në kompetencë të gjykatës civile dhe anasjellas. Vetë termi “mosmarrëveshje” që përdor ligji, e ka bazën dhe rrjedh nga konfliktet mes palëve, të cilat lindin kur ato kanë interesa të ndryshme ose të kundërta, të cilat e cenojnë njëra-tjetrën. Megjithatë, këto konflikte në mes palëve shndërrohen në “mosmarrëveshje” në kuptim të ligjit, atëherë kur ato parashtrihen në mënyrën e përcaktuar nga ligji përpara gjykatës, me anë të kërtimeve konkrete, qofshin këto në formën e padisë, kundërpadisë apo edhe të ndërhyrjes kryesore. Nga sa më sipër, gjykata që po gjykon padinë bëhet kompetente për kundërpadinë nëse ligji i ka dhënë të drejtën që të shqyrtojë kërkitime të tilla që bëjnë pjesë në kompetencën lëndore të saj. Në të kundërt, nëse kundërpadia ka një natyrë tjetër, të tillë që bën kompetente një tjetër gjykatë, gjykata që e shqyrton padinë nuk mund të thotë se është kompetente për ta shqyrtuar kundërpadinë nisur nga fakti se po shqyrton padinë.

27. Në këtë këndvështrim, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë se kur i paraqitet kundërpadia, për shkak të lidhjes ose të kompensimit me padinë, përpara se të vlerësojë këto kritere, duhet të verifikojë nëse ligji i ka dhënë asaj të drejtën për t'i dhënë përgjigje kërkitimit të parashtruar në kundërpadi. Nëse ligji nuk ia ka dhënë të drejtën, pra kompetencën lëndore që të marrë në shqyrtim pretendimet që ngrihen në gjykim me anë të kundërpadisë, ajo nuk mund të bëhet kompetente, pavarësisht lidhjes apo kompensimit që kërkitimet e kundërpadisë kanë me kërkitimet e padisë.

28. Pra me daljen e ligjit të ri për gjykatat administrative, ligjvënësi ka krijuar tashmë gjykata të posaçme, të cilat nga pikëpamja lëndore do të gjykojnë vetëm çështje administrative. Në

mbështetje të analizës së mësipërme, neni 55 i Kodit të Procedurës Civile gjen zbatim vetëm për kundërpadi të cilat kanë kompetencë lëndore të njëjtë me padinë. Pra, gjykata civile do të pranojë për shqyrtim vetëm kundërpadi që janë të natyrës civile, e po kështu gjykata administrative mund të pranojë për shqyrtim vetëm kundërpadi të natyrës administrative. Vetëm pas verifikimit të kompetencës së tyre lëndore, gjykatat do të marrin në shqyrtim kriteret e tjera të pranueshmërisë së padisë, të parashikuara në nenin 55 të Kodit të Procedurës Civile.

29. Një qëndrim të tillë mbajnë edhe legjislacionet e huaja, në vendet që kanë gjykata administrative, si: Italia, Gjermania, Franca etj. Sipas jurisprudencës së këtyre shteteve, gjykata që po shqyrton padinë bëhet kompetente për shqyrtimin e kundërpadisë nëse ekziston lidhja objektive në mes tyre, por gjithmonë kur kundërpadia i përket kompetencës lëndore të asaj gjykate.²

30. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë e çmojnë të rëndësishme çështjen e kompetencës lëndore të gjykatave, për shkak të rëndësisë që ka në zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, një ndër elementet themelore të të cilit është “gjykata e krijuar me ligj”. Në këtë kontekst, fjala “ligj”, sipas nenit 42 të Kushtetutës, përfshin edhe legjislacionin për krijimin dhe kompetencën e gjykatave, ku kompetenca për gjykimin e “mosmarrëveshjeve” administrative i është caktuar vetëm gjykatës administrative, ashtu siç mosmarrëveshjet civile mund t'i shqyrtojë vetëm gjykata civile. Nëse një gjykatë nuk ka kompetencë lëndore për të

² Sipas jurisprudencës italiane, kundërpadia që nuk e përjashton kompetencën lëndore të gjyqtarit që po shqyrton padinë, mund të pranohet kur kërkitimet e kundërpadisë varen nga i njëjti titull që janë në themel të padisë, por mund të kenë edhe tituj të ndryshëm mbi të cilët bazohen, por mjafton që të kenë lidhje objektive në mes tyre (Cass., 7 Marzo 1985, N. 1873).

Kur kundërpadia i përket kompetencës lëndore të një gjyqtari tjetër, gjykimi i njëkohshëm i tyre) (*il simultaneus processus*), i parashikuar në nenin 36 të K.Pr.Civile, nuk mund të vazhdojë nga gjyqtari kompetent për shqyrtimin e padisë. Në një rast të tillë të derogohet nga kriteri i përgjithshëm i kompetencës për shkak të lidhjes në mes të këtyre kërtimeve dhe secila duhet të paraqitet dhe shqyrtohet nga gjyqtari kompetent sipas rregullave të zakonshme, me pasojën e ndarjes së gjykimeve të lidhura ... (Cass., 28 Giugno 1975, N. 2567). Po kështu, në vendimin Cass., 7 Febbraio 1996, gjykata është shprehur se ... në rastin e kundërpadisë së paraqitur nga i padituri që e tejkalon kompetencën në vlerë të gjykatës që po shqyrton padinë, ai duhet të vendosë ndarjen e çështjeve, duke mbajtur çështjen të cilën e ka në kompetencë ekskluzive dhe duke ia dërguar kundërpadinë, gjykatës kompetente për vlerën e atij kërkitimi.



shqyrtuar një kundërpadi si një kërkim i ngritur në një gjykim, sipas legjislacionit përkatës, kjo gjykatë nuk është “e krijuar me ligj” sipas kuptimit të nenit 42/2 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të Konventës. Është qëndrim i konsoliduar tashmë i jurisprudencës se mosrespektimi i ligjit procedural lidhur me kompetencën lëndore, përbën një cenim të rëndë të rendit kushtetues dhe juridik, si cenim të drejtpërdrejtë të procesit të rregullt ligjor, shkelje e cila bie ndesh me pikën 2 të nenit 42 të Kushtetutës.

31. Në lidhje me këtë përfundim, Gjykata Kushtetuese ka një praktikë të konsoliduar. Kështu, kjo gjykatë, ndërmjet të tjerave, në vendimet nr. 41, datë 29.12.2005, nr. 14, datë 17.4.2007 dhe nr. 11, datë 23.4.2009 ka disponuar se shprehja “*gjykatë ... e caktuar me ligj*” në nenin 42/2 të Kushtetutës, mbulon jo vetëm bazën ligjore për vetë ekzistencën e gjykatës, por edhe kompozimin e trupit gjyqësor të ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështjeje konkrete”.

Po në lidhje me rëndësinë e respektimit të kompetencës lëndore, Gjykata Kushtetuese shprehet edhe se shqyrtimi i një çështjeje “... nga një gjykatë jo kompetente nuk përbën në çdo rast vetëm një shkelje procedurale, por ka të bëjë edhe me respektimin e së drejtës kushtetuese për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj. Marrja nga një gjykatë e kompetencës që i takon me ligj një gjykatë tjetër mund të bëhet vetëm nëse e lejon ligji dhe vetëm nga gjykatat që ai cakton”. Më tej, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se: “Mosrespektimi i kompetencës lëndore e bën vendimin gjyqësor absolutisht të pavlefshëm dhe pretendimi për respektimin e kësaj kompetence mund të ngrihet si nga palët në çdo fazë të procesit ... gjykimi i një çështjeje në kompetencën lëndore të një gjykatë tjetër përbën “një proces jo të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit të 6/1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”. Së fundi, Gjykata Kushtetuese është shprehur në mënyrë të qartë dhe direkte se “Gjykata e Lartë, si organi më i lartë i pushtetit gjyqësor, ka për detyrë funksionale që të mbajë të gjitha gjykatat brenda kufijve të kompetencave të tyre (sidomos kompetencës lëndore) Pretendimi i mungesës së kompetencës lëndore është i rëndësishëm për verifikimin e kushtetutshmërisë së procesit të zhvilluar në ato gjykata”.

32. Në këto kushte, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në interpretimin unifikues se: ***Nëse në një gjykim civil paraqitet një kundërpadi e natyrës administrative, gjykata që po shqyrton padinë nuk mund të shqyrtojë***

këtë kërkim të të paditurit për shkak të mungesës së kompetencës lëndore të gjykatës që po shqyrton padinë. Nëse në një gjykim administrativ paraqitet një kundërpadi e natyrës civile, gjykata që po shqyrton padinë nuk mund të marrë në shqyrtim edhe kundërpadinë, për shkak se i mungon kompetenca lëndore e saj.³

33. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vërejnë se mbështetur në rregullimet ligjore, i njëjti standard interpretimi vlen edhe për gjykatën që do të shqyrtojë kërkimet e një padie, kur këto kërtime kanë natyrë të ndryshme me njëri-tjetrin, të tilla që përcaktojnë kompetencë lëndore të gjykatave të veçanta. Pavarësisht se një çështje e tillë nuk është shtruar për unifikim, Kolegjet çmojnë se duhet marrë në shqyrtim prej tyre, pasi është rrjedhojë logjike e interpretimit të kryer në këtë vendim, lidhur me padinë dhe kundërpadinë që janë të natyrave të ndryshme.

34. Neni 23, i ligjit nr. 49/2012, parashikon se: “Në një kërkesëpadi mund të parashtrohen disa kërtime, në rast se gjykata është kompetente për të gjitha kërkimet ...”. Të njëjtun rregullim e parashikon edhe neni 159 i Kodit të Procedurës Civile, kur shprehet se “Në një kërkesëpadi mund të parashtrohen shumë kërtime, në rast se gjykata është kompetente për të gjitha kërkimet...”. Në interpretim të kundërt të këtyre dispozitave, në një kërkesëpadi nuk mund të parashtrohen kërtime që nuk hyjnë në kompetencën lëndore të gjykatës së cilës i drejtohet kërkesëpadia. Nëse këto kërtime të natyrave të ndryshme parashtrohen në një kërkesëpadi, në kuptim të dispozitave ligjore të mësipërme, rregullimit ligjor të ndryshëm, parimeve të ndryshme të gjykimit civil dhe atij administrativ, gjykata ku këto kërtime paraqiten nuk mund t’i gjykojë të gjitha. Në këto kushte, pavarësisht faktit nëse këto kërtime janë një bashkim i thjeshtë apo i ndërvarur i tyre, gjykata ku ato janë paraqitur është e detyruar që t’i ndajë dhe të shpallë moskompetencën për ato kërtime të cilat ligji i ka përcaktuar në kompetencën lëndore të një gjykatë tjetër.

35. Në koherencë me arsyetimin e kryer më lart, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se praktika gjyqësore e deritanishme e

³ Kundër këtij qëndrimi të arritur lidhur me çështjen e parë të shtruar për unifikim, janë shprehur kundër gjyqtarët: Mirela Fana, Medi Bici, Artan Broci.



njësuar me vendimin nr. 4, datë 10.12.2013 do të duhet të ndryshohet edhe për çështjet me kërkitime të përziera. Kërkimet e natyrave të ndryshme civile dhe administrative, si ato të parashtruara në kundërpadi, e po ashtu edhe ato të parashtruara me anë të padisë, tashmë nuk mund të gjykohen më së bashku, pasi ligji ka përcaktuar që duhen gjykuar nga gjykata të ndryshme.

36. Konkretisht, në vendimin nr. 4, datë 10.12.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, është njësuar praktika, si më poshtë:

“A. Kur në objektin e gjyimit ka disa kërkitime si të natyrës civile dhe administrative dhe këto kërkitime konstatohen nga gjykata se janë një bashkim i thjeshtë i tyre, atëherë referuar nenit 61 dhe 159 të Kodit të Procedurës Civile dhe 13 dhe 2 të ligjit nr. 49/2012, gjykata duhet të veçojë objektet që nuk janë në kompetencën e saj lëndore duke ia kaluar ato gjykatës kompetente.

B. Kur në objektin e gjyimit ka disa kërkitime si të natyrës civile dhe administrative dhe këto kërkitime konstatohen nga gjykata se janë një bashkim i ndërruar mes tyre, atëherë referuar nenit 55 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 24 të ligjit nr. 49/2012 dhe zbatimit të parimit “lex specialis derogat generali”, gjykata kompetente është si më poshtë:

- kur në objektin e gjyimit pala paditëse ndër të tjera ka për objekt kundërshtimin e një akti administrativ dhe nga pasojat e aktit prodhohen pasoja civile në çdo rast, kompetente është gjykata administrative;

- kur një ndër objektet e gjyimit është një kërkim me natyrë civile, por që është i lidhur ngushtë me aktin administrativ dhe pasojat e këtij akti kanë ardhur nga vullneti shtetëror, atëherë përsëri gjykatë kompetente është gjykata administrative;

- kur objektet e tjera të padisë jo të natyrës së mosmarrëveshjes administrative janë të ndërruar nga pasojat e aktit administrativ dhe në këtë rast kjo të çon te kompetenca e gjykatës administrative.

37. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se pavarësisht diferencës së pakët kohore në mes të këtyre dy vendimeve njësuese, duke pasur për bazë vijimësinë e deritanishme të praktikës gjyqësore, problemet që kanë rezultuar me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 49/2012, të cilat janë përmendur edhe më lart, fakti se praktika në lidhje me gjykimet administrative është akoma e pakonsoliduar, ka vend për të ndryshuar vendimin nr. 4, datë 10.12.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, lidhur me mënyrën e shqyrtimit nga gjykatat, të kërkitimeve me natyra të ndryshme

brenda një padie.

38. Kushtetuta e RSH-së, në nenin 141/2 njeh vetëm dy forma të vendosjes së precedentëve nga Gjykata e Lartë: njësimin e praktikës gjyqësore dhe ndryshimin e kësaj praktike. Vetë sistemi gjyqësor ka si funksion të tijin interpretimin e ligjeve duke i aplikuar ato në lidhje me rrethanat e një çështjeje konkrete. Vendimet njësuese apo ndryshuese të praktikave të mëparshme të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë janë ligj për gjykatat në gjykimin e rasteve të ngjashme. Këto vendime janë reflektim i praktikës gjyqësore të gjykatave të faktit, ose edhe të vetë Gjykatës së Lartë, e po kështu edhe reflektim i ndryshimeve ligjore. Vetë praktika e Gjykatës së Lartë mund të evoluojë, duke reflektuar problematikat e sistemit gjyqësor, e po kështu në funksion të sigurisë juridike, interpretimit dhe aplikimit sa më të drejtë dhe koherent të ligjit, vetë kjo gjykatë mund të ndryshojë praktikën e saj. Ndryshimi i praktikës gjyqësore është standard i njohur në të gjitha vendet e tjera, e po kështu ndiqet edhe nga vetë Gjykata e Strasburgut. Konkretisht, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 49/2012, fakti që në gjykime të ndryshme ka paditë që përmbajnë kërkitime të natyrave të ndryshme, ka sjellë një ngërc të madh në sistemin gjyqësor, me shumë mosmarrëveshje kompetencash në mes gjykatave të natyrave të ndryshme. Në këtë kuptim Kolegjet vlerësojnë se ndryshimi i praktikës gjyqësore është i nevojshëm dhe i diktuar nga praktika gjyqësore.

39. Në këto kushte, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë e ndryshojnë interpretimin njësues të dhënë ligjit nr. 49/2012, në prg. 46, pikat “A” dhe “B” të vendimit nr. 4, datë 10.12.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë⁴, si vijon:

Kur në objektin e gjyimit të një çështjeje ka disa kërkitime si të natyrës civile dhe administrative, këto kërkitime pavarësisht faktit nëse kanë një lidhje të thjeshtë në mes tyre, apo janë edhe të ndërruara nga njëra-tjetra, referuar neneve 61 dhe 159 të Kodit të Procedurës Civile dhe 13 dhe 23 të ligjit nr. 49/2012, gjykata duhet të veçojë kërkitimet që nuk janë në kompetencën e saj lëndore, duke ia kaluar ato gjykatës kompetente.

⁴ Pika C e këtij paragrafi ka mbetur e pandryshuar.



II. Në lidhje me çështjen e dytë të shtruar për unifikim

40. Çështja e dytë që u shtrua për unifikim ka të bëjë me: Si do të veprohet në lidhje me kompetencën lëndore të gjykatës në lidhje me shqyrtimin e kundërpadisë, në gjykimin në shkallë të parë, apel dhe Gjykatë të Lartë, për çështjet në të cilat kundërpadia është paraqitur para datës 4.11.2013.

41. Një trajtim i tillë vërehet se kërkon vëmendje nga ana e Kolegjeve të Bashkuara, nisur nga disa faktorë. Pas datës 4.11.2013, për shkak të hyrjes në fuqi të ligjit nr. 49/2012, çdo çështje e natyrës administrative, pavarësisht gjendjes dhe shkallës së gjykimit, i kaloi gjykatave administrative. Siç është analizuar edhe në vendimin nr. 3, datë 6.12.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, gjykata civile nuk mund të shqyrtonte më të tilla çështje, për shkak se ligji nr. 49/2012 ia hoqi kompetencën dhe ia kaloi gjykatave administrative. Këtyre gjykatave i kaluan edhe çështjet që ishin akoma në proces, nisur nga fakti se ligji nr. 49/2012 nuk kishte parashikuar me anë të ndonjë dispozite transitorë se cili ishte ligji i zbatueshëm procedural në lidhje me çështjet, gjykimi i të cilave nuk kishte përfunduar akoma.

42. Pavarësisht sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara vërejnë se ndarja për shkak të kompetencës lëndore e kërtimeve të natyrave të ndryshme brenda një padie ose ndarja po për këtë shkak e kundërpadive me natyrë të ndryshme nga padia, kur këto kërtime janë paraqitur përpara datës 4.11.2013, nuk do të sillte pasoja pozitive në lidhje me zhvillimin e procesit gjyqësor në tërësi dhe do të sillte vështirësi që do të ndikonin në zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor.

43. Situata faktike e çështjeve në të cilat kërkimet në padi ose kundërpadi janë paraqitur përpara datës 4.11.2013, të cilat janë në gjykim e sipër nëpër gjykata, është e tillë që këto gjykime mund të jenë në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, gjykimi i tyre edhe mund të ketë përfunduar në shkallë të parë dhe mund të jenë duke u gjykuar në shkallë të tjera. Duhet pasur parasysh se janë të shumta çështjet e tilla në të cilat padia ka disa kërtime, të tilla që në kuptim të përcaktimit të kompetencës lëndore, pas datës 4.11.2013, i përkasin gjykatave të ndryshme. Kjo për shkak se rregullimi ligjor i mëparshëm nuk i evidentonte ndarjet e krijuara me ligjin nr. 49/2012 dhe

parashtrimi i kërtimeve të tilla nuk krijonte ndonjë problem në kuadër të kompetencës lëndore të gjykatës. Në të tilla kushte, ndarja e këtyre çështjeve me arsyetimin se gjykata ku janë paraqitur nuk është kompetente për vazhdimin e shqyrtimit të gjitha kërtimeve, do të paraqiste një sërë problematikash. Në të njëjtën kohë nuk do t'i shërbente as interesave të drejtësisë dhe të qytetarëve, në drejtëm të dhënies së një vendimi brenda një afati të arsyeshëm kohor. Pavarësisht se kërkimet e një kundërpadie apo kundërpadi, të cila për shkak të ligjit nr. 49/2012 nuk mund të jenë më në kompetencë të gjykatës ku janë paraqitur, në kohën e parashtrimit të tyre, gjykata e cila ka qenë kompetente për marrjen e tyre në shqyrtim dhe në respektim të parimit "*perpetuatio fori*" do të vazhdojë gjykimin e tyre.

44. Kolegjet e Bashkuara theksojnë se nëse këto çështje ndahen në një moment të tillë, duhet pasur parasysh pasoja që sjell kjo ndarje. Kalimi i çështjeve nga një gjykatë në tjetrën, për shkak të kompetencës lëndore, siç ishte kalimi i çështjeve në gjykatën administrative pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 49/2012, ka një tjetër natyrë dhe problematikë nga ndarja e kërtimeve të ndryshme në një çështje. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se pamundësia e ndarjes së kërtimeve të ndryshme në një çështje të paraqitur në gjykatë para datës 4.11.2013, paraqitet në disa aspekte që do të trajtohen më poshtë.

45. Së pari, nëse çështja ka përfunduar në shkallë të parë nuk mund të ndahet në gjykatë të apelit e aq më pak në Gjykatë të Lartë. Do të përbënte nonsens juridik që dy gjykata të ndryshme të vendosin mbi të njëjtën vendim të shkallës së parë, duke e copëzuar atë. E thënë ndryshe, gjykata e apelit civil të vendosë në lidhje me një pjesë të arsyetimit dhe të dispozitivit të shkallës së parë dhe gjykata administrative e apelit, në lidhje me pjesën e mbetur. Nga ana tjetër, nuk mund të mendohet ndjekja e standardeve të ndryshme, në lidhje me ndarjen e çështjeve në shkallë të ndryshme gjykimi. E thënë ndryshe, nuk mund të ndahen kërkimet e natyrave të ndryshme gjatë gjykimit të çështjes që vijon në shkallë të parë, ndërsa në gjykata më të larta të gjykohen së bashku. Një diferencim i tillë do të shkonte përtej interpretimit të ligjit në kuadër të njësimi të praktikës dhe dhënies së drejtësisë në mënyrë të njëjtë në të gjitha shkallët e gjykimit. Në parim nuk ka një parashikim ligjor



që të vendosë standarde të ndryshme në lidhje me procedurat e gjykimit.

46. Së dyti, kërkimet brenda një padie mund të jenë të tilla që kanë natyrë të ndërvarur nga njëra-tjetra dhe dhënia zgjidhje e një kërkimi varet nga përfundimi i tjetrit. Në këto kushte, do të pezullohej njëri nga gjykimet deri në zgjidhjen përfundimtare me vendim të formës së prerë të kërkimit tjetër, duke sjellë një zvarritje të pajustificuar të gjykimeve, kur tashmë ato janë pranuar të gjykohen së bashku. Palët ndërgjyqëse në gjykimin e filluar në kohën që nuk kishte hyrë akoma në fuqi ligji nr. 49/2012, presin përgjigje nga gjykata brenda një afati të arsyeshëm në lidhje me kërkimet e tyre. Qëllimi i ligjvënësimit me miratimin e ligjit nr. 49/2012, nuk ka qenë zvarritja e gjykimeve, por përkundrazi përshpejtimi i tyre, duke pasur parasysh vetë procedurën dhe afatet kohore të shkurtra në lidhje me gjykimet administrative.

47. Vonesat që sjell ndarja e kërkimeve të natyrave të ndryshme në një çështje, cenojnë stabilitetin dhe sigurinë e marrëdhënieve juridike në mes të subjekteve të së drejtës. Nga ana tjetër, ato kufizojnë të drejtën e shtetasve për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm, si pjesë e të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Në kuadër të KEDNJ-së, është detyrim i shteteve garantimi i afatit të arsyeshëm kohor të gjykimit të një çështje, me qëllim mbrojtjen të gjitha palëve ndërgjyqëse nga vonesat e gjata procedurale dhe dhënien fund të pasigurisë së interesave të shtetasve.

48. Në vendimin njësoes nr. 3, datë 6.12.2013, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë janë shprehur se: *“Parimi i gjykatës së caktuar me ligj, i të drejtës së ankimit, si dhe i sigurisë juridike janë ngushtësisht të lidhura me njëra-tjetrën. Si element i sigurisë juridike, mbrojtja e pritshmërive të ligjshme nga rendi juridik ka të bëjë me të drejtën që kanë personat fizikë dhe juridikë për të gëzuar pasojat e pritshme të rendit juridik në fuqi në kohën kur ata ushtrojnë të drejtat e tyre të ligjshme. Për më tepër, kur këtyre personave i vijnë pasoja të pafavorshme nga ndryshimi i legjislacionit, ky i fundit nuk mund të veprojë me efekt prapaveprues. Parimi i përgjithshëm është se masat me efekte të pafavorshme dhe njëkohësisht prapavepruese janë të ndaluara dhe përjashtimet mund të parashikohen vetëm në rastet kur synohen të mbrohen interesa publike më të larta dhe në raste të përcaktuara qartë nga ligjvënësi”* (shih prg. 27). Njëkohësisht, Gjykata Kushtetuese është shprehur se: *“...ligjvënësi duhet të mbajë parasysh se një*

situatë të rregulluar më parë, parimisht mund ta ndryshojë vetëm nëse kjo sjell pasoja pozitive për subjektet përfituese dhe jo kur ndryshimi i akteve e përqëson situatën, pra i heq subjekteve fituese një të drejtë të fituar më parë.....” (Shih vendimin nr. 2/2013; vendimin nr. 9/2007 të Gjykatës Kushtetuese).

49. Është e rëndësishme të theksohet se një interpretim i tillë kryhet për shkak të një situatë kalimtare dhe të përkohshme, për një kategori të caktuar çështjesh, duke mbajtur parasysh parimin e sigurisë juridike, përfundimin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm kohor në kuptim të nenit 6 të KEDNJ-së, si dhe parimin e pritshmërive të ligjshme të shtetasve. Në këto kushte, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë se në lidhje me çështjet e përmendura më sipër gjykimi duhet të vazhdojë në të njëjtën gjykatë, pa u lidhur me ndryshimet e mëvonshme të kompetencës lëndore të gjykatës në lidhje me disa prej kërkimeve në padi apo kundërpadi.

50. Në vijim të kësaj analize, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në konkluzionin njësoes se:

i) Çështjet në të cilat gjatë gjykimit është paraqitur një kundërpadi, e cila ka natyrë të ndryshme nga ajo e padisë (respektivisht administrative ose civile), në rast se kundërpadia është paraqitur në gjykatë para datës 4.11.2013, do të vazhdojnë të gjykohen në gjykatën kompetente për shqyrtimin e padisë, si në gjykimin në shkallë të parë, gjykatë të apelit apo Gjykatë të Lartë;

ii) Çështjet të cilat në objektin e tyre kanë disa kërkime si të natyrës civile dhe administrative, kërkime të cilat janë paraqitur përpara datës 4.11.2013, do të vazhdojnë të gjykohen nga gjykata ku ato janë paraqitur.⁵

51. Në këtë aspekt, problem i cili duhet trajtuar dhe që kërkon vëmendje është edhe ligji mbi bazën e të cilit gjykatat do të vazhdojnë shqyrtimin e këtyre çështjeve dhe do t'i zgjidhin ato.

52. Neni 72 i ligjit nr. 49/2012 ka parashikuar se: *“1. Në datën e fillimit të funksionimit të gjykatave administrative hyjnë në fuqi ndryshimet e mëposhtme: a) në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; iii) nenet nga 324 deri në 333 shfuqizohen”*. Në referim të kësaj dispozite transitorie të ligjit nr. 49/2012,

⁵ Në lidhje me këtë çështje kanë shprehur mendimin e tyre kundër gjyqtarët Ardian Dvorani, Ardian Nuni, Aleksandër Muskaj, Arjana Fullani, Evelina Qirjako, Artan Zeneli.



vërehet se janë shfuqizuar dispozitat ligjore në të cilat mbështetej vendimmarrja e gjykatës në lidhje me gjykimin e çështjeve administrative. Prandaj nga ana e gjykatave civile do të vazhdojë gjykimi i çështjes në tërësi duke zbatuar rregullat e procesit gjyqësor civil. Megjithatë, duke pasur parasysh se gjykatat civile, për shkak të situatës kalimtare, do të shqyrtojnë edhe disa kërkitime që mund të jenë kërkitime të padisë ose të kundërpadisë, të cilat janë të natyrës administrative, për dhënien zgjidhje të këtyre kërkitimeve ato do të zbatojnë për aq sa munden, pa i rënë ndesh procedurës së gjykimit civil dhe pa vështirësuar gjykimin e çështjes, rregullat e gjykimit administrativ. Në këtë kuptim, pa cenuar rregullat e gjykimit civil, në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së këtyre kërkitimeve me natyrë administrative, gjykatat civile do të mbajnë parasysh parashikimet e nenit.40 të ligjit nr. 49/2012. Po kështu e kundërta, edhe gjykatat administrative që për shkak të kësaj situate kalimtare do të gjykojnë kërkitime të natyrës civile, do të mbajnë parasysh rregullat e Kodit të Procedurës Civile. Këtu bëhet fjalë për ato çështje që u kanë kaluar gjykatave administrative nga vendimi nr. 3, datë 6.12.2013, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe që krahas padive me natyrë administrative, kanë edhe kundërpadi apo kërkitime me natyrë civile. Për shkak të dallimeve që kanë gjykimi administrativ me gjykimin civil, duke filluar që te barra e provës, mënyra e gjykimit të çështjes, vendimi që merret etj., gjykatat, deri në ezaurimin e kësaj situate kalimtare do të vazhdojnë të gjykojnë sipas ligjit që rregullon kompetencën e tyre lëndore, pra gjykatat civile sipas Kodit të Procedurës Civile dhe gjykatat administrative sipas ligjit nr. 49/2012.

III. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes

53. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vërejnë se kërkitimi i padisë së ngritur nga ana e paditëses Marjana Përnuca ka të bëjë me të drejtën e pronarit për kërkimin e sendit nga posedues të paligjshëm, e drejtë kjo me natyrë private. Ndërkohë, kundërpadia ka të bëjë me pretendimin e të paditurit Gjok Shota, se titulli i pronësisë së paditëses, e konkretisht akti i marrjes së tokës në pronësi është i pavlefshëm, duke kërkuar edhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme.

54. Në vendimin nr. 2, datë 10.3.2014, Kolegjet e Bashkuara janë shprehur se: "... mosmarrëveshjet që burojnë nga aktet e marrjes së tokës në pronësi, që kanë të bëjnë me kundërshtimin e tyre, janë të

natyrës administrative, pavarësisht natyrës civile të pasojave që akti i dhënies së tokës në pronësi apo përdorim ka sjellë për palët e interesuara" (prg. 24). Nga shqyrtimi i dosjes gjyqësore, rezulton se i padituri Gjok Shota e ka ngritur kundërpadinë në muajin shtator 2013. I padituri e ka paraqitur kundërpadinë në gjykatën ku po gjykohej padia, brenda të njëjtit proces gjyqësor, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë.

55. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë me vendimin nr. 36, datë 5.2.2014, ka vendosur të shpallë moskompetencën e saj në lidhje me këtë çështje dhe dërgimin e akteve Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si gjykata kompetente në zgjidhjen e çështjes. Në këtë vendim, gjykata ka arsyetuar se gjykimi i kundërpadisë ka natyrë administrative dhe ky objekt është primar në raport me objektin e padisë, prandaj kompetenca lëndore i takon gjykatës administrative.

56. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin e seancës përgatitore të datës 26.2.2014, ka vendosur të ngrejë çështjen e mosmarrëveshjes për kompetencë para Gjykatës së Lartë, duke arsyetuar se mosmarrëveshja në mes të palëve është e natyrës civile, pasi kërkitimi i padisë lidhet me të drejta të pronësisë dhe pikërisht me padinë e rivendikimit të parashikuar nga neni 296 i Kodit Civil. Sipas kësaj gjykate, në referim të interpretimit unifikues të dhënë në vendimin nr. 4, datë 10.12.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, çështja duhet gjykuar nga gjykata civile.

57. Në mbështetje të analizës së deritanishme dhe qëndrimit unifikues, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se nisur nga fakti se kundërpadia është paraqitur përpara datës 4.11.2013 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, shqyrtimi i padisë dhe i kundërpadisë do të vazhdojë të kryhet së bashku, në një gjykim të vetëm. Gjykata kompetente që do të shqyrtojë çështjen do të jetë gjykata civile, pra Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, e cila e kishte kompetencën për shqyrtimin e kundërpadisë në momentin e paraqitjes së saj.

58. Nisur nga sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se vendimi nr. 36, datë 5.2.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë duhet prishur dhe çështja duhet dërguar në po atë gjykatë për vazhdimin e gjykimit.



PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 485/c të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSËN:

Prishjen e vendimit nr. 36, datë 5.02.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe dërgimin e çështjes për vazhdimin e gjykimit në po atë gjykatë.

Ky vendim është unifikues dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Xhezair Zaganjori (kryesues), Guxim Zenelaj, Edmond Islamaj, Shkëlzen Selimi, Tom Ndrecka, Admir Thanza, Artan Broci

Anëtarë kundër: Ardian Nuni, Ardian Dvorani, Aleksandër Muskaj, Arjana Fullani, Evelina Qirjako, Artan Zeneli

Anëtarë kundër pjesërisht: Mirela Fana, Medi Bici

MENDIM PAKICE

Në gjyqtarët **Artan Broci** dhe **Medi Bici** nuk jemi dakord në lidhje me **pikën e parë** të unifikimit në vendimin nr. 3, datë 28.4.2014, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për arsyet si më poshtë vijojnë:

Çështja u tërhoq për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara për të orientuar e udhëhequr praktikën gjyqësore për zbatimin e njëlojtë dhe të përpiktë të normave të së drejtës procedurale, lidhur me konfliktet e kompetencës lëndore, në lidhje me pyetjet:

Nëse në një gjykim civil paraqitet një kundërpadi e natyrës administrative ose e kundërta (në një gjykim administrativ paraqitet një padi e natyrës civile), si do të veprojë gjykata në lidhje me kompetencën lëndore për shqyrtimin e këtyre kërtimeve?

Si do të veprohet në lidhje me kompetencën lëndore në gjykimin në shkallë të parë, apel dhe Gjykatë të Lartë, për çështjet në të cilat kundërpadia është paraqitur dhe pranuar për t'u marrë në shqyrtim para datës 4.11.2013? Po në rastet kur kundërpadia është paraqitur para datës 4.11.2013, por gjykata ka pranuar të marrë (ose e merr) në shqyrtim kundërpadinë pas kësaj date?

I. Në lidhje me tërheqjen e çështjes për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara

Në si gjyqtarë të pakicës vlerësojmë se, referuar legjislacionit aktual, i cili rregullon rastet e dërgimit të një çështjeje për gjykim në Kolegjet e Bashkuara, në kontekstin e çështjes konkrete të dërguar nga ana e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë (*mosmarrëveshje kompetencash*), ajo nuk është një prej rasteve të parashikuara për dërgim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për unifikimin e praktikës. Në këtë përfundim arrijmë pas një interpretimi sistematik, literal dhe logjik të të gjithë kuadrit ligjor që rregullon dërgimin e çështjes për gjykim pranë Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Neni 141/2 i Kushtetutës disponon se “Për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë ka të drejtë të tërheqë për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore.”

Ligji “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, në nenin 14 të tij parashikon çështjet që gjykohen në Kolegjet e Bashkuara, të cilat janë: “...a) rastet e parashikuara në Kodin e Procedurës Civile dhe Kodin e Procedurës Penale; b) ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë; c) kërkesat për njësimin dhe ndryshimin e praktikës”.

Kodi i Procedurës Civile, në nenin 481 të tij, me titull “**Shqyrtimi në Kolegjet e Bashkuara**”⁶ parashikon se: “Kryetari i Gjykatës së Lartë mund të vendosë që gjykata të shprehet në Kolegje të Bashkuara **për rekurse të paraqitura nga palët, për të cilat ka praktika të ndryshme e të mëparshme në kolegjet e thjeshta**. Në këto raste Kryetari i Gjykatës së Lartë cakton relatorin dhe datën e shqyrtimit të rekursit”.

Nga interpretimi i dispozitave të mësipërme, rezultojnë disa përfundime sikurse janë se: i) është e drejta e Gjykatës së Lartë të tërheqë për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore për njësimin apo ndryshimin e praktikës së deritanishme; ii) rastet janë përcaktuar shprehimisht në nenin 14 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, dhe iii) saktësimi i detyrave dhe rolit të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, i cili mund të vendosë që gjykata të shprehet në Kolegje të Bashkuara: a) **për rekurse të paraqitura nga palët, b) rekurse për të cilat ka praktika të ndryshme e të mëparshme në kolegjet e thjeshta**.

⁶ Shfuqizuar fjalia e fundit e paragrafit të dytë me vendimin nr. 46/1999, të Gjykatës Kushtetuese; ndryshuar titulli, shfuqizuar paragrafi me ligjin nr. 8812, datë 17.05.2001, neni 90.



Në rastin konkret nuk ndodhemi përpara një rekursi dhe aq më pak përpara praktikave të ndryshme të Kolegjeve të Gjykatës së Lartë, pasi vetë Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë iu është referuar rasteve të paraqitura për shqyrtim dhe qëllimi ka qenë shmangia në të ardhmen e qëndrimeve të ndryshme.

Ky arsyetim nuk gjen mbështetje ligjore, pasi ne vlerësojmë se para se të ndërmerret një iniciativë ligjore nga autoritetet kompetente për të thirrur Kolegjet e Bashkuara për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore duhet të ekzistojë një praktikë gjyqësore (dhe jo raste), qoftë e gabuar apo qoftë kontradiktore, në mënyrë që Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë ta unifikojnë, ta njësojnë apo ta ndryshojnë atë. Ky parashikim kushtetues mbron Gjykatën e Lartë ndaj prirjes për “ndërhyrje” kundrejt së drejtës ekskluzive të pushtetit ligjvënës për të bërë ligj dhe së drejtës ekskluzive të pushtetit gjyqësor për të interpretuar ligjin edhe kur ky është kontradiktor, i paqartë apo mungon (shiko nenin 1, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile).

Ne vlerësojmë se kjo çështje nuk duhet dërguar për gjykim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë referuar edhe ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, ku në nenin 13 të tij është parashikuar rregullimi specifik i mosmarrëveshjeve të kompetencave (midis gjykatave), lëndore, funksionale dhe tokësore.

Në pikën e parë të nenit 13 parashikohet se: “Moskompetenca lëndore dhe funksionale ngrihet edhe kryesisht në çdo gjendje dhe shkallë të shqyrtimit”.

Më tej në pikën 6 parashikohet se: “Mosmarrëveshjet zgjidhen nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i cili vendos në dhomë këshillimi me tre gjyqtarë brenda 10 ditëve nga data e marrjes së akteve. Vendimi u njoftohet menjëherë gjykatave në mosmarrëveshje dhe palëve”.

Nga përmbajtja e paragrafit të sipërcituar, rezulton i shprehur qartë vullneti i ligjvënësit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në lidhje me kompetencën, qoftë kur paraqitet nga gjykatat dhe qoftë kur kemi ankim të palëve. Vendimmarrja e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë për tërheqjen e çështjes në Kolegjet e Bashkuara nuk gjen mbështetje ligjore dhe si e tillë ajo është e pabazuar në ligj.

Për sa më sipër, çështjes së dërguar në Kolegjet e Bashkuara duhet t'i jepej përgjigje nga ana e

Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, me tre gjyqtarë brenda 10 ditëve dhe jo në seancë publike.

II. Në lidhje me pikën e parë të njësimin të praktikës nga ana e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues

Nëse i referohemi dispozitave të ligjit nr. 49/2012, vëmë re se ai nuk është thjesht një ligj organik që rregullon vetëm çështjet e organizimit dhe të funksionimit të gjykatave administrative dhe statusin e gjyqtarëve. Ky ligj parashikon, gjithashtu, edhe parime të përgjithshme të gjykimit administrativ dhe norma procedurale që lidhen me juridiksionin, kompetencën e gjykatave administrative, përbërjen e gjykatave sipas shkallëve të gjykimit dhe natyrës së çështjeve, si dhe fazat procedurale të gjykimit deri në ekzekutimin e vendimit. Pra, në tërësi, ky ligj është me natyrë procedurale.

Duke studiuar në mënyrë harmonike dhe të integruar Kodin e Procedurave Civile dhe ligjin nr. 49/2012, ku në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, është parashikuar se “Dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj **nuk parashikon ndryshe**”, në kushtet kur ligji nr. 49/2012 nuk ka parashikuar rregulla në lidhje me kundërpadinë (kujtojmë këtu se ka rregulluar bashkimin e kërtimeve dhe bashkimin e padive, respektivisht nenet 23 dhe 24), **pra nuk ka bërë parashikimet specifike**, vlen përcaktimi i Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon kundërpadinë, neni 55 i Kodit të Procedurës Civile, i cili ka këtë formulim: “**Gjykata që gjykon padinë kryesore është kompetente për të shqyrtuar edhe kërkesat dytësore, kundërpadinë ose ndërhyrjen kryesore.** Në këtë rast gjykata merr vendim për bashkimin e tyre në një çështje të vetme”. Vetëm në rast se vërehet një parashikim i ndryshëm nga ai tashmë i parashikuar në Kodin e Procedurës Civile, gjykata duhet të zbatohet dhe të interpretojë ligjin specifik, pra nr. 49/2012 dhe jo parashikimet e Kodit të Procedurës Civile.

Gjithashtu, duke analizuar ligjin nr. 49/2012 vërehet se ky ligj sipas teknikës legjislative ka parashikuar dispozita kalimtare në lidhje me shfuqizimet e disa parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile, **pasi ligji nr. 49/2012 parashikon disa rregullime specifike** dhe



përkatësisht në nenin 72 të tij parashikohet se: “1. Në datën e fillimit të funksionimit të gjykatave administrative hyjnë në fuqi ndryshimet e mëposhtme: a) Në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurave Civile i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

- Neni 35 pika “b” të Kodit të Procedurës Civile
- Paditë për kundërshtimin e akteve administrative me vlerë 20 milionë lekë .

- Neni 320 pika “a” të Kodit të Procedurës Civile - Në përbërje të gjykatave të rretheve krijohen seksione të veçanta për gjykimin e: a) mosmarrëveshjeve administrative;

- Nenet 324 deri në 333 të Kodit të Procedurës Civile.

Si konkluzion, në kushte kur nuk kemi shprehje të vullnetit për rregullime specifike apo shfuqizime në lidhje me kundërpadinë, rrjedhimisht vlejnë rregullimet e parashikuara nga neni 55 i Kodit të Procedurës Civile.

Pranojnë se, fuqia prapavepruese e ligjit është lidhur kryesisht me ligjin material dhe ajo nuk është në natyrën e ligjit procedural. Është vetë ligji procedural ai që duhet të përcaktojë se si duhet vepruar me rastin e hyrjes në fuqi të tij dhe për këtë shkak u referohemi dispozitave kalimtare në çdo rast.

Nga leximi me kujdes, në mënyrë të integruar dhe harmonizuese të dispozitave transitore të ndryshimeve të Kodit të Procedurës Civile të vitit 2013⁷ dhe dispozitat transitore të ligjit nr. 49/2012⁸, kuptohet qartë vullneti i legjislatorit **për veprimin në kohë të ligjit procedural** dhe mbi të gjitha raporti juridik ndërmjet gjykimit të zakonshëm dhe

gjykimit administrativ për sa i përket çështjes së kompetencës lëndore dhe atribuitimit të saj për çdo çështje para dhe pas datës 4.11.2013.

Rezultoi se në datë 1.9.2013 (*akoma pa hyrë në fuqi ligji për gjykimin administrativ*), kanë hyrë në fuqi dispozitat e ndryshuara të Kodit të Procedurës Civile. Legjislatori ka parashikuar se “Çështjet civile që janë në gjykim ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë të gjykoen sipas ligjit të kohës së paraqitjes së kërkesëpadisë.” Pra, theksohet **sipas ligjit të kohës së paraqitjes së kërkesëpadisë** (*tempus regit actiones*).

Ndërkohë, në datën 4.11.2013 ka hyrë në fuqi ligji për gjykimet administrativ, ligj, i cili parashikon se “1. Në datën e fillimit të funksionimit të gjykatave administrative hyjnë në fuqi ndryshimet e mëposhtme: a) në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar: i) në nenin 35, shkronja “b” shfuqizohet; ii) në nenin 320, shkronja “a” shfuqizohet; iii) nenet nga 324 deri në 333 shfuqizohen.”. Në datë 17.10.2013, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka miratuar një ndryshim në dispozitat tranzitore të Kodit të Procedurës Civile të ndryshuar me ligjin nr.122/2013, duke parashikuar se “Neni 49, “Dispozitë kalimtare”, i ligjit nr. 122/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë: “Çështjet civile që janë në gjykim në gjykatën e shkallës së parë dhe në gjykatën e apelit, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë të gjykoen sipas ligjit të kohës së paraqitjes së kërkesëpadisë”. Ky ligj parashikonte hyrjen në fuqi pas 15 ditësh nga dita e botimit në Fletoren Zyrtare, dhe duke qenë se është botuar në datën 12.11.2013, ka hyrë në fuqi në datën 28.11.2013.

Pavarësisht sa më sipër ka parashikuar legjislatori, Gjykata e Lartë me vendimin unifikues nr. 3/2013, ka shfuqizuar “*de facto*” dispozitat kalimtare të Kodit të Procedurës Civile, hyrë në fuqi në datën 1.9.2013 dhe ndryshimet në dispozitat transitore, të miratuar në Kodin e Procedurës Civile me ligjin nr.122/2013. Gjykata e Lartë me vendimin unifikues nr. 3/2013, duke arsyetuar ndër të tjera se: “...Sa më sipër, në dispozitat procedurale kalimtare të ligjit të ri procedural, mund të parashikohen çështjet ndaj të cilave ai nuk do t'i shtrijë efektet e menjëhershme, afatin ose kohën gjatë së cilës ky ligj nuk do të veprojë. Në këto raste, i takon ligjvënësit të shprehet lidhur me efektet në kohë të ligjit procedural. Pra, është vetë ligjvënësi i cili duhet të shprehet se nuk do të

⁷ Shiko ligjin 122/2013 botuar në Fletoren Zyrtare nr. 67, datë 3.5.2013, faqe 2989, hyrë në fuqi në datën 1.9.2013. Neni 49 i këtij ligji, me titullin “Dispozitë kalimtare”, parashikon se “Çështjet civile që janë në gjykim ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë të gjykoen sipas ligjit të kohës së paraqitjes së kërkesëpadisë”. Ligji nr. 160/2013 botuar në Fletoren Zyrtare nr. 180, datë 12.11.2013, në nenin 1 ka parashikuar se “Neni 49, “Dispozitë kalimtare”, i ligjit nr. 122/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë: “Çështjet civile që janë në gjykim në gjykatën e shkallës së parë dhe në gjykatën e apelit, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë të gjykoen sipas ligjit të kohës së paraqitjes së kërkesëpadisë”.

⁸ Neni 72/a i ligjit 49/2012 botuar në Fletoren Zyrtare nr. 53, datë 16.5.2012, faqe 2701, i hyrë në fuqi në datën 4.11.2012. Në nenin 72/a, nën titullin “Shfuqizime dhe ndryshime”, ky ligj disponon se “1. Në datën e fillimit të funksionimit të gjykatave administrative hyjnë në fuqi ndryshimet e mëposhtme: a) në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar: i) në nenin 35, shkronja “b” shfuqizohet; ii) në nenin 320, shkronja “a” shfuqizohet; iii) nenet nga 324 deri në 333 shfuqizohen”.



zbatohet ligji i ri procedural, por ai i vjetri, gjë që do të thotë se vetë ligji i ri duhet të ketë të përcaktuar qartë se në lidhje me çfarë problemesh dhe deri në çfarë afati kohor do të vazhdojë të zbatohet ligji i vjetër procedural dhe jo ai që është në fuqi. Po kështu, vetë ligji i ri procedural në mënyrë të shprehur duhet të përcaktojë nëse norma e re procedurale nuk do të zbatohet menjëherë, por në një kohë të ardhme, kohë të cilën vetë ligji duhet ta specifikojë. Nëse kjo ndodh, atëherë, pavarësisht se ligji ka hyrë në fuqi, ai nuk i shtrin efektet menjëherë dhe ndaj çështjeve që janë në gjykim ...”, ka mënjanuar vullnetin e ligjvënësit, materializuar në këto dispozita transitorë.

Për sa më sipër, vlerësojmë se nga interpretimi harmonizues dhe kronologjik i dispozitave transitorë të të dy ligjeve del se, **në rastin konkret nuk ka asnjë lloj ometimi apo kontradiksioni ligjor. Është e qartë se për çështjet në të cilat kundërpadia është paraqitur dhe pranuar për t'u marrë në shqyrtim para datës 4.11.2013, edhe në rastet kur kundërpadia është paraqitur para datës 4.11.2013, por gjykata ka pranuar të marrë (ose e merr) në shqyrtim kundërpadinë pas kësaj date, gjykatat do të zbatojnë të gjithë kuadrin ligjor që ka qenë në fuqi në kohën e ngritjes së padisë, pasi edhe ligji nr. 49/2012 në lidhje me paraqitjen e kundërpadisë, i referohet Kodit të Procedurës Civile.**

Nga ana tjetër, pas datës 4.11.2013, për çdo padi të paraqitur para një gjykate, kompetenca lëndore e nenit 7, të ligjit nr. 49/2012, do t'u përkiste ekskluzivisht gjykatave administrative, të cilat do të zbatonin tashmë vetëm dispozitat procedurale të ligjit të ri dhe në mënyrë komplementare me Kodin e Procedurës Civile, përveç neneve **35, 320, 324-333** të tij, që në datën 4.11.2013 janë shfuqizuar **dhe, në këtë frymë, gjykatat administrative duhet të zbatojnë edhe nenin 55 të Kodit të Procedurës Civile.**

Kolegjet e Bashkuara në vendimin unifikues nr. 3, viti 2013, kanë arsyetuar se “... Ligji material dhe ai procedural kanë elemente referimi të ndryshëm për sa i përket zbatimit të tyre. Zbatimi i ligjit material lidhet me momentin kur ka ndodhur shkelja, kufizimi apo lindja e së drejtës. Për këtë arsye, si rregull, në rastet kur në fillim apo vijim të procesit gjyqësor ndryshon ligji material, do të vazhdojë të zbatohet ligji i mëparshëm. Përgjashtim bëjnë rastet kur vetë ligji i ri ka parashikuar fuqinë prapavepruese të tij.

Nga ana tjetër, zbatimi i ligjit procedural lidhet me momentin kur zhvillohet gjykimi për shqyrtimin e mosmarrëveshjes para gjykatës. Në ndryshim nga ligji

material, ligji procedural do të zbatohet kur gjykata vibet në lëvizje për shqyrtimin e një mosmarrëveshjeje. Nëse gjatë shqyrtimit gjyqësor të një çështjeje, ligji procedural ndryshon, atëherë në gjykim do të zbatohet ligji i ri, me përjashtim të rastit kur vetë ky ligj në dispozitat kalimtare ka parashikuar që për njëfarë kohe ose rrethana të caktuara, të vazhdojë zbatimi i ligjit të vjetër procedural...”.

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Gjykata Kushtetuese, e cila ka theksuar vazhdimisht për kushtetutshmërinë e një procesi duke theksuar se, në të drejtën procedurale, ndryshe nga ajo materiale, ligji i ri ka fuqi edhe për çështjet që janë në gjykim, me përjashtim të rastit kur vetë ai shprehet ndryshe duke parashikuar dispozita procedurale kalimtare (vendimi nr. 11/2009 të Gjykatës Kushtetuese). Ky përjashtim nga rregulli, është në vullnetin e legjislatorit, i cili shprehet në parashikimin e dispozitave kalimtare për zbatimin e ligjit të vjetër procedural.

E njëjta logjikë dhe praktikë juridike e ligjvënësit, në respektim të nenit 42 dhe 135 të Kushtetutës, është ndjekur me krijimin në Republikën e Shqipërisë të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit për krimet e rënda. Kështu, neni 11/2 i ligjit nr. 9110, datë 24.7.2003 dispononte se “çështjet penale, që do të jenë në gjykim në gjykatat e shkallës së parë e të apelit deri në ditën e fillimit të funksionimit të gjykatave për krime të rënda, do të përfundohen nga këto gjykata”. Ndërkohë nën të njëjtin logjikë kushtetuese neni 13/3 (i ndryshuar) i Kodit të Procedurës Penale dispononte se “gjykatat e apelit për krimet e rënda shqyrtojnë në shkallë të dytë, me trup gjykues të përbërë nga pesë gjyqtarë, çështjet e gjykuara nga gjykata e krimeve të rënda”. Ligjvënësi, nëpërmjet këtyre dy dispozitave, ashtu sikur me dispozitat transitorë të Kodit të Procedurës Civile të vitit 2013, është kujdesur që të krijojë vijueshmëri të procesit.

Sjellim në vëmendje vendimin unifikues penal nr. 1, datë 16.4.2004, i cili ka unifikuar praktikën se “Gjykata e Apelit e Krimeve të Rënda nuk mund të shqyrtojë në shkallë të dytë çështje që janë shqyrtuar në shkallë të parë nga gjykatat e rretheve gjyqësore para datës 1.1.2004, të cilat, sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurave Penale, janë në kompetencë të gjykatave të krimeve të rënda.” Po ashtu, më parë kësaj sentence unifikuese, në të njëjtin vendim, megjithëse jo me statusin e unifikimit, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë pranuan se nuk mundet kurrsesi çështjet që janë për gjykim në gjykatat e rretheve gjyqësore, pas



prezantimit të kompetencës lëndore të re të gjykatës së krimeve të rënda, t'i kalojnë kësaj të fundit.

Për sa më sipër, ne gjyqtarët e mendimit të pakicës vlerësojmë se në rastin kur Kolegjet e Bashkuara i japin përgjigje pyetjes ligjore të ngritur para tyre se - ***kur në një gjykim civil paraqitet një kundërpadi e natyrës administrative ose e kundërta (në një gjykim administrativ paraqitet një padi e natyrës civile), gjykata që ka kompetencën lëndore për shqyrtimin e këtyre kërtimeve është Gjykata Administrative - ky qëndrim unifikues është qartë një kapërcim i veprimtarisë së Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë mbi domenin ekskluziv të pushtetit ligjvënës, duke e shfuqizuar në fakt dispozitën e nenit 55 të Kodit të Procedurës Civile, dhe duke bërë ligj, gjë e cila është qartazi ndërhyrje në pushtetin legjislativ dhe shkelje e parimit të ndarjes së pushteteve në Republikën e Shqipërisë. Në këtë mënyrë ndryshohet aksioma e njohur dhe pranuar se kundërpadia ndjek fatin e padisë.***

Vlerësojmë se, edhe me këtë ometim të pretenduar ligjor, sërish gjykatat në vendimmarrjet e tyre do të duhet të bazoheshin në ligjin material dhe ligjin procedural dhe, kur nuk ka ligj, ato do të duheshin të mundoheshin të krijonin vetë një normë të tillë nga materiali dhe kuadri normativ në fuqi, jurisprudenca, doktrina e mbi të gjitha Kushtetuta (shiko nenin 1, paragrafi i dytë, i Kodit të Procedurës Civile). Në vijim të kësaj ideje, Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 28, datë. 16.12.2008, nën të njëjtën logjikë ka interpretuar se “Në bazë të këtij parimi gjykata duhet të kërkojë gjithmonë brenda rendit juridik të shtetit shqiptar normën që rregullon një rast konkret. Ajo duhet të mbështetet në një autoritet që ka forcën e ligjit dhe që zgjidh mosmarrëveshjen konkrete. Në rast se një normë e tillë nuk ekziston, ajo duhet të kërkojë edhe norma të tjera që rregullojnë rastet analoge. Gjykata, për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje ka detyrën funksionale për të kryer interpretime të ndryshme në lidhje me kuptimin e normave, me kërkimin e normave që rregullojnë rastet analoge apo me identifikimin e parimeve të përgjithshme dhe të jurisprudencës kushtetuese”.

Duke iu kthyer çështjes konkrete, kundërpadia është e parashikuar shprehimisht në nenin 160 të Kodit të Procedurës Civile, në të cilin parashikon se: “I padituri ka të drejtë të paraqesë kundërpadi kur kërkitimi i kundërpadisë ka lidhje me atë të padisë ose kur

midis tyre mund të bëhet kompensimi.

Kundërpadia mund të paraqitet derisa nuk ka përfunduar hetimi gjyqësor dhe u nënshtrohet të gjitha rregullave të caktuara për ngritjen e padisë.

Kur të metat e kundërpadisë nuk plotësohen në afatim e caktuar nga gjykata, kundërpadia ketbehet”.

Nga interpretimi i dispozitës së mësipërme, rezulton se legjislatori i njeh të paditurit të drejtën për të paraqitur kundërpadi, në një gjykim të nisur. I padituri në gjykim, i thirrur rregullisht nga pala paditëse mund të mbajë kundrejt kërtimeve të padisë sjellje të ndryshme, që mund të kenë synim lejimin ose ndalimin e pranimit të padisë dhe që përbëjnë mbrojtjen e të paditurit në gjykim.

Në rast se sjellja e të paditurit është e tillë që i kundërdrejtohet paditësit për të ndaluar pranimin e padisë së tij, në vetvete kjo sjellje do të nënkuptojë dy kategori: kundërshtime që e mbajnë konfliktin gjyqësor brenda kufijve të kërkesëpadisë, të cilat i quajmë prapësime - dhe kundërshtime që zgjerojnë kufijtë e (objektit) padisë me kërtime të tjera të të paditurit kundrejt paditësit, të cilat i quajmë kundërpadi.

Në këtë kuptim, kundërpadia është padia e të paditurit, një akt/mjet procedural drejtuar kundrejt paditësit, në mbështetje së të drejtave dhe interesave të personit/personave të paditur, me një funksion të dyfishtë; i cili konsiston në mbrojtjen e tij ndaj kërtimeve të paditësit dhe në të njëjtën kohë përmbushin të drejtën subjektive apo interesin e ligjshëm (që parashtrohet në objektin e kundërpadisë), që ka i padituri ndaj paditësit dhe që ushtrohet në një gjykim të filluar nga paditësi. Kundërpadia është parashikuar si një e drejtë/interes procedural i të paditurit dhe duhet vullneti i tij për ta bërë pjesë kundërpadinë në një gjykim të nisur.

Vlerësohet, gjithashtu, se përveç vullnetit të të paditurit për të paraqitur ose jo kundërpadi, nga interpretimi logjik dhe sistematik i neneve 55 dhe 160 të Kodit të Procedurës Civile, rezultojnë edhe disa kushte-premisa për të pranuar një kundërpadi në një proces apo gjykim të nisur midis palëve.

Kushti i parë i pranimit të një kundërpadie është plotësimi i të gjitha kushtet që ka vendosur legjislatori për paraqitjen e padisë, si në formë ashtu edhe në përmbajtje. Pra, kundërpadia duhet të jetë e materializuar në një dokument, në formë të shkruar, në gjuhën shqipe, ku të jenë materializuar, gjithashtu, kërkesat e neneve 154



dhe 154/a, të Kodit të Procedurës Civile.

Kushti i dytë rezulton nga paragrafi i parë i nenit 160 të Kodit të Procedurës Civile, i cili nënkupton, se kundërpadi mund të paraqitet nga ana e të paditurit në ato raste, kur:

i) Kërkimi i kundërpadisë ka lidhje me atë të padisë (koneksiteti), pra kur ndërmjet kërkimeve të padisë dhe të kundërpadisë nuk ka ndryshime në bazën juridike dhe në shkakun ligjor, dhe që pretendimet e padisë dhe të kundërpadisë duhet të ketë lidhje apo koneksitet me njëri-tjetrin;

ii) Kur objekti i kundërpadisë mund të bëjë kompensim me objektin e padisë;

iii) Kur jemi para një kundërpadie paragjykimore (prejudiciale), e cila paraqitet për njohjen ose mosnjohjen e një marrëdhënie juridike ose të një të drejte subjektive, nga qenia apo mosqenia e kësaj marrëdhënie ose e së drejtës subjektive, varet tërësisht ose pjesërisht vendimi i gjykatës mbi objektin e padisë.

Kushti i tretë i pranimit të kundërpadisë është paraqitja e saj para se gjykata të marrë vendimin e mbylljes së hetimit gjyqësor, pra para vendimmarrjes së ndërmjetme, sipas nenit 302 të Kodit të Procedurës Civile. Kjo për faktin se hetimi gjyqësor, i plotë dhe i gjithanshëm sipas nenit 14 të Kodit të Procedurës Civile, duhet të realizohet edhe për kundërpadinë. Me paraqitjen e kundërpadisë fillon edhe marrëdhënia procedurale juridike e saj pasi zhvillimi i procesit gjyqësor për padinë është i pavarur nga ai i kundërpadisë. Pavarësisht kësaj, meqenëse gjykimi zhvillohet bashkërisht, provat e paraqitura për padinë vlejnë dhe mund të përdoren edhe për kundërpadinë.

Kushti i katërt i pranimit të një kundërpadie lidhet me subjektet që dalin palë në kundërpadi, të cilat duhet të jenë të njëjta, por me pozita procedurale të kundërta me ato të padisë. Në kundërpadi, i padituri është paditës dhe e drejton kërkimin e tij kundër paditësit që merr pozitën e të paditurit. Nga lidhja që ekziston midis padisë dhe kundërpadisë, pala e paditur që paraqet kundërpadinë quhet i paditur kundërpaditës dhe pala ndaj së cilës drejtohet kundërpadia quhet paditës i kundërpaditur. Si përjashtim nga ky rregull, mund të thirren në gjykimin e nisur edhe persona të tjerë, kur janë kushtet e bashkëndërgjyqësisë, për të mbrojtur interesat e tyre duke u dëgjuar, në zbatim të parimit të

kontradiktorialitetit.

Vlerësohet nga ana jonë se, sipas interpretimit të dispozitave që rregullojnë kundërpadinë, vullneti i legjislatorit në lidhje me kushte-premisat, që duhet të verifikojnë gjykatat e shkallës së parë, në momentin procedural të paraqitjes së një kundërpadie në një proces gjyqësor të nisur më parë nga palët, janë vetëm ato të sipërpërmendura, ku asnjëra prej të cilave nuk lidhet me kompetencën lëndore. Ky përfundim mbështetet nga përmbajtja e nenit 55 të Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon se: “Gjykata që gjykon padinë kryesore është kompetente për të shqyrtuar edhe kërkesat dytësore, kundërpadinë ose ndërhyrjen kryesore. Në këtë rast, gjykata merr vendim për bashkimin e tyre në një çështje të vetme”.

Kolegjet e Bashkuara kanë unifikuar qëndrimin e tyre se: “Kur në objektin e gjykimit të një çështje ka disa kërkime si të natyrës civile dhe administrative, këto kërkime pavarësisht faktit nëse kanë një lidhje të thjeshtë në mes tyre, apo janë edhe të ndërvarura nga njëra-tjetra, referuar neneve 61 dhe 159 të Kodit të Procedurës Civile dhe 13 dhe 23, të ligjit nr. 49/2012, gjykata duhet të veçojë kërkimet që nuk janë në kompetencën e saj lëndore, duke ia kaluar ato gjykatës kompetente”.

Ne vlerësojmë se ky përfundim nuk është në përputhje me frymën animus dhe qëllimin ratio të ligjvënësit, i cili ka parashikuar dhe rregulluar kundërpadinë. Përmbajtja e nenit 55 të Kodit të Procedurës Civile, i interpretuar në harmoni me nenin 160 të Kodit të Procedurës Civile, themelon nga pikëpamja procedurale një lloj të ri kompetence, e cila është kompetenca për shkak koneksiteti, pra të lidhjes së qëndrueshme që kanë kërkimet e kundërpadisë, me padinë që hyn në kompetencë të gjykatës. Praktika gjyqësore dhe doktrina ka mbajtur qëndrimin e konsoliduar se kundërpadia, si padi që parashtrohet në një padi tjetër me të cilën ka lidhje, shqyrtohet nga e njëjta gjykatë e cila edhe po të mos jetë kompetente nga pikëpamja e lëndës dhe e tokës, që të shqyrtojë kundërpadinë po t'i parashtrohet si padi e veçantë, bëhet kompetente për shkak të koneksitetit, d.m.th. të lidhjes me padinë që hyn në kompetencën e gjykatës⁹.

⁹ Procedura civile e Republikës Popullore të Shqipërisë. Alqiviadh Lamani, Tiranë 1962, f. 113



Vlerësojmë se mundësinë e paraqitjes së kundërpadisë nga i padituri ligji e ka paraparë me qëllim që në të njëjtën gjykatë, e cila tashmë zhvillon një proces unik dhe vendos me një aktgjykim, të zhvillohen dhe të zgjidhen në mënyrë komplekse kundërshtimet midis palëve, si dhe me qëllim që të evitohet vendosja kontradiktore (në varie judicetur) në çështjet juridike të lidhura midis tyre. Kjo në fund të fundit i shërben pa dyshim parimit të ekonomisë në gjykim dhe zvogëlon rrezikun e dhënies së dy vendimeve kontradiktore, midis të njëjtave palë për të njëjtin kërkim apo kërtime të lidhura. Pra, si konkluzion theksojmë se qëllimi i parashikimit të kësaj kompetence është që t'u jepet përgjigje ezauruese dhe përfundimtare të gjitha çështjeve që janë ngritur ose mund të ngrihen në një proces gjyqësor dhe përjashtimit të mundësisë së dhënies së dy vendimeve të kundërta nga dy gjykata, në linjën e parimit të ekonomizimit të procesit gjyqësor.

Për sa më sipër, është analizuar mospranimi nga ana e gjykatës, në një proces të nisur, i një kundërpadie të paraqitur nga i padituri, që në themel të saj ka një natyrë mosmarrëveshje administrative, ose e anasjella (pra të ndryshme nga natyra e padisë), i humbet kuptimin e vërtetë dhe qëllimin e parashikimit të një norme të tillë në ligjin procedural civil dhe nihilizon një lloj të veçantë kompetence, kompetencën për koneksitet parashikuar shprehimisht nga neni 55 i Kodit të Procedurës Civile.

I vetmi përjashtim nga rregulli, konsiderohet rasti kur për kundërpadinë është kompetente një gjykatë më e lartë se ajo që është duke vepruar sipas padisë apo gjykata e llojit tjetër. Në një rast të tillë i padituri për kërkesën e tij (kundërpadinë), mund të kërkojë mbrojtje juridike me anë të padisë në gjykatën kompetente, përmendim këtu kompetencën funksionale të parashikuar nga neni 10, pika 2, germa “b” e ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Në këtë rast, kundërpadia nuk mund të shqyrtohet së bashku me padinë, për arsye se gjykata e shkallës më të ulët nuk mund të bëhet kompetente për shkak koneksiteti (kompensimi apo prejudiciale), të shqyrtojë edhe kundërpadinë. **Pra legjislacioni, procedural civil e përcakton qartë se kur**

gjykatës që po gjykon një padi i paraqitet edhe një kundërpadi, për të cilën është kompetente një gjykatë më e lartë apo një gjykatë tjetër, ajo nuk mund ta pranojë për gjykim këtë kërkim të të paditurit, pasi nuk ka bazë ligjore për një vendimmarrje të tillë, por duhet të orientojë palën e paditur që ta paraqesë këtë padi para gjykatës kompetente.

Edhe në qoftë se përbërja e gjykatës nuk është e njëjtë për të dyja paditë (padinë dhe kundërpadinë), trupi gjykues mund të vendosë bashkimin e gjykimeve me qëllim të shqyrtimit të përbashkët.

Sipas rregullës që kompetenca themelohet në momentin e paraqitjes së padisë përpara një gjykate, kompetenca e themeluar me parashtrimin e kundërpadisë nuk ndikohet as me tërheqjen e mëvonshme të padisë e as me hedhjen poshtë të saj. Gjykatës së cilës i është parashtruar kundërpadia mbetet për këtë kompetente edhe po të shpallet jokompetente për gjykimin e padisë.

Kundërpadia është parë si e drejtë e të paditurit e jo edhe si detyrë procedurale e tij. Ajo formalisht i shërben të paditurit si mjet sulmi kundër paditësit, por shpeshherë ka rëndësi të mjetit mbrojtës. I padituri nuk është i detyruar që kërkesën e tij ta realizojë me anë të kundërpadisë. Një gjë të tillë ai mund ta bëjë me anë të padisë me të cilën inicion proces kontestimor të veçantë. Duke qenë se kundërpadia, si mjet mbrojtës i të paditurit, është në thelb një e drejtë dhe jo një detyrim procedural civil, respektimi i kësaj të drejte duhet të jetë në proporcion të plotë me të drejta të tjera të procesit të rregullt ligjor, gjykatën e krijuar me ligj, parimin e sigurisë juridike, afatin e arsyeshëm, si dhe ekonominë gjyqësore.

Në mbështetje të përfundimit të arritur mbrohen disa parime të rëndësishme:

Së pari, **koncepti i gjykatës së krijuar me ligj (gjyqtarit natyral)**, elaboruar nga e drejta ku konceptin e gjykatës së krijuar me ligj e paraqesin si të drejtë themelore të individit, ku qëllimi i krijimit dhe mbrojtjes kushtetuese të saj është te nevoja për të qenë tej çdo dyshimi dhe mundësie e paanshme përgjatë gjithë procesit gjyqësor. Para së gjithash, gjykata duhet të jetë e krijuar me ligj, ku të jetë përcaktuar qartë **kompetenca lëndore dhe tokësore e saj** në shqyrtimin e çështjeve. *Me fjalë të tjera, ligji për krijimin e gjykatës duhet t'i paraprijë shqyrtimit të çështjeve konkrete.* Kjo do të thotë se në momentin kur çdo subjekt është bërë titullar i një procesi gjyqësor dhe



përballë tij është caktuar një gjyqtar (gjykatë), që në kohën dhe momentin e caktimit ka marrë juridiksion dhe kompetencë, ka garancinë e akteve se nuk do të ketë mundësi që ky gjyqtar të spostohet, ndryshohet (*translatio iudicii*) apo të shndërrohet më vonë *ex ante factum* në gjykatë/gjyqtar pa juridiksion apo jokompetent.

Parimi i sigurisë juridike: Gjykata Kushtetuese në vendimin 43/2011, ka vlerësuar se “siguria juridike, mbrojtja e të drejtave të fituara, **si dhe e pritshmërive të ligjshme**, si standarde kushtetuese të trajtuara vazhdimisht nga jurisprudenca kushtetuese ... Rregullimet ligjore që kanë të bëjnë me të drejtat e shtetasve duhet të kenë qëndrueshmëri të mjaftueshme që siguron vijueshmërinë e tyre. Si rregull, nuk mund të moboben interesa dhe pritshmëri të ligjshme të qytetarëve nga ndryshimet në legjislacion dhe shteti duhet të synojë të ndryshojë një situatë të rregulluar më parë vetëm nëse **ndryshimi sjell pasoja pozitive...** (shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 34, datë 20.12.2005; nr. 9, datë 26.2.2007; nr. 4, datë 12.2.2010, nr. 24, datë 12.11.2008; nr. 31, datë 18.6.2010).

Standardi i afatit të arsyeshëm – GJEDNJ-ja, ashtu si edhe Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e tyre të konsoliduar kanë përcaktuar se çdo shtet anëtar, d.m.th. palë e lartë kontraktuese, duhet ta përcaktojë dhe parashikojë në mënyrë të tillë organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor që të mundësojë përmbushjen e këtij detyrimi kushtetues. Me paraqitjen e kundërpadisë, me natyrë administrative, çdo proces gjyqësor detyrohet të konstituohet edhe njëherë rishtazi në gjykatat administrative, duke u bërë nul një proces i mëparshëm. Apriori kjo praktikë gjyqësore sjell cenimin e procesit të rregullt ligjor të gjitha proceset gjyqësore që detyrohen të nisnin nga e para, pikërisht në elementin e afatit të arsyeshëm.

Ekonomia gjyqësore - Gjykata në vendimmarrjen e saj duhet të mbajë parasysh parimin kushtetues dhe procedural të ekonomisë gjyqësore procesuale, derivat i drejtpërdrejtë i procesit të rregullt ligjor, konkretisht i së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

Megjithëse Kushtetuta dhe ligji nuk e artikulojnë në mënyrë eksplicite, institutet procedurale dhe vetë ligji procedural është hartuar duke pasur parasysh parimin e kërkesës dhe nevojës për ekonomi gjyqësore, pasi në ligjin procedural civil janë sqaruar institutet si

bashkëndërgjyqësitë aktive dhe pasive procedurale, kalimi dhe zëvendësimi procedural, personat e tretë, ndërhyrja kryesore, litispendenca, bashkimi i padive, bashkimi i kërtimeve apo bashkimi i çështjeve etj., duke nënkuptuar edhe kundërpadinë. Në arritjen e këtij konkluzioni gjykata duhet të mbajë parasysh jo kuptimin e ngushtë (*stricto sensu*) të këtij parimi, d.m.th., jo vetëm kohën fizike apo kohëzgjatjen e procedimit, por kuptimin e gjerë (*lato sensu*) të këtij parimi dhe benefitin për të cilin është parashikuar në legjislacionin procedural civil.

Referuar sa më sipër, në gjyqtarët e pakicës jemi kundër unifikimit të praktikës nga ana e Kolegjeve të Bashkuara, të arritur në pikën e parë dhe që ka të bëjë me ndarjen e çështjeve.

Vetë qëndrimi i shumicës në pikën e parë të këtij unifikimi vjen në kundërshtim me pikën e dytë, ku në fakt që një pjesë e shumicës së pikës së parë u bashkua me gjyqtarët e pakicës për mosndarjen çështjes në gjykim, duke ndryshuar apo korrigjuar vetë vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 6.12.2013, por vetëm sa u takon çështjeve me kundërpadinë, duke lejuar vazhdimin e përfundimit të gjykimeve në ato gjykata ku kishin filluar gjykimet.

Anëtarë: Artan Broci, Medi Bici

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtarja Mirela Fana, jam gjyqtare në pakicë në lidhje me çështjen e parë të unifikimit të praktikës gjyqësore në vendimin nr. 3, datë 28.4.2014, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku shumica ka vendosur se: **“nëse në një gjykim civil paraqitet një kundërpadi e natyrës administrative, gjykata që po shqyrton padinë nuk mund të shqyrtojë këtë kërkim të të paditurit për shkak të mungesës së kompetencës lëndore të gjykatës që po shqyrton padinë. Nëse në një gjykim administrativ, paraqitet një kundërpadi e natyrës civile, gjykata që po shqyrton padinë nuk mund të marrë në shqyrtim edhe kundërpadinë për shkak se i mungon kompetenca lëndore e saj”**.

2. Si gjyqtare në pakicë jam e mendimit se, përfundimi i arritur në sentencën e parë unifikuese në vendimin nr. 3, datë 28.4.2014, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nuk ka ezauruar qëllimin dhe problematikën e çështjeve të vëna në bisedim në këtë gjykim për



efekt unifikimi, për sa i përket kuptimit juridik, sistematik dhe të harmonizuar të termave dhe çështjeve që kanë të bëjnë me mjetet procedurale në procesin gjyqësor si “padia” dhe “kundërpadia”.

3. Qëndrimi i shumicës që ka arritur në sentencën njësuere se nëse në një gjykim paraqitet një kundërpadi e cila ka natyrë të ndryshme nga ajo e padisë (respektivisht administrative ose civile) ato duhen veçuar, është i gabuar.

4. Kam mendimin se qëndrimi i shumicës së Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë bie ndesh me nenin 55 të Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon qartazi në pjesën relevante të tij se: *“Gjykata që gjykon padinë kryesore është kompetente për të shqyrtuar edhe ... kundërpadinë...”*, si dhe nenin 160 të Kodit të Procedurës Civile, i cili jep përkufizimin e mjetit procedural të kundërpadisë, duke përcaktuar se: *“I padituri ka të drejtë të paraqesë kundërpadi kur kërkitimi i kundërpadisë ka lidhje me atë të padisë ose kur midis tyre mund të bëhet kompensimi...”*.

5. Në interpretim të dispozitave procedurale të sipërcituara, legjislatori jep një përkufizim të vetëm të kundërpadisë, i cili vlen si për një kundërpadi që për nga pikëpamja lëndore është e natyrës civile, ashtu edhe për një kundërpadi administrative.

6. Në terminologjinë e neneve 55 dhe 160 të Kodit të Procedurës Civile, të para në harmoni mes tyre, është evidente se qëllimi i legjislatorit nuk ka qenë kufizimi i përdorimit të kundërpadisë si mjet procedural vetëm për kërkitime që i përkasin së njëjtës natyrë mosmarrëveshjeje nga pikëpamja lëndore, pra ngritja vetëm e një kundërpadie civile në rastet e padisë civile apo ngritja vetëm e një kundërpadie administrative në rastet e padisë administrative. Nëse ky do të kishte qenë qëllimi i legjislatorit, atëherë ai do të ishte shprehimisht i pasqyruar në dispozitat e mësipërme, qoftë në momentin e hyrjes në fuqi të Kodit të Procedurës Civile, qoftë përgjatë ndryshimeve që ai ka pësuar me kalimin e kohës, qoftë edhe në ndryshimet më të fundit ku një pjesë e dispozitave të këtij Kodi u shfuqizuan me qëllim pikërisht funksionimin e gjykatave administrative.

7. Kundërpadia përbën mjetin dhe të drejtën subjektive procedurale që ligjvënësi i ka njohur të paditurit për të mbrojtur të drejtat dhe pretendimet e tij, të cilat i kundërdrejtohen

paditësit, jo më tashmë thjesht në formën e prapësimeve, por në formën e një pretendimi të ri, të lidhur për nga objekti i kërkitimit me objektin e padisë apo kur ndërmjet padisë dhe kundërpadisë mund të kryhet kompensimi. E thënë ndryshe, kundërpadia përbën padinë e të paditurit kundër paditësit **brenda të njëjtit gjykim**, me anë të cilit i padituri kërkon arritjen e një përfitimi të ndryshëm nga thjesht rrëzimi i padisë.

8. Kushtet kumulative të ekzistencës së kundërpadisë janë krejtësisht të qarta, të përcaktuara nga neni 160 i Kodit të Procedurës Civile; **së pari** kundërpadia të ngrihet nga i padituri kundër paditës brenda të njëjtit gjykim ku shqyrtohet padia, pa përfunduar faza e hetimit gjyqësor; **së dyti** kërkitimi i kundërpadisë të lidhet me atë të padisë apo mes tyre të kryhet kompensimi. Në asnjë dispozitë ligjore në fuqi nuk pasqyrohet kriteri që përpos kushteve të mësipërme, duhet të plotësohet edhe një kusht i tretë kumulativ, e konkretisht që objekti i një kundërpadie të jetë i së njëjtës natyrë lëndore me objektin e padisë, në mënyrë që ajo të shqyrtohet nga gjykata që shqyrton padinë.

9. Nëse do të analizonim me radhë nivelin e koneksitetit të kërkuar nga neni 160 i Kodit të Procedurës Civile mes një padie dhe një kundërpadie, me qëllim shqyrtimin e kësaj të fundit nga gjykata që shqyrton padinë sipas nenit 55 të Kodit të Procedurës Civile, do të arrinim në konkluzionin se nga vetë përkufizimi i kundërpadisë, një prej rasteve të ngritjes së saj është ekzistenca e lidhjes mes objektit të saj dhe objektit të padisë, ç’ka në vetvete nuk prezumon të qenit e këtyre objekteve të së njëjtës natyrë nga pikëpamja lëndore.

10. Po ashtu, edhe rasti i dytë se kur mund të ngrihet kundërpadia i referohet një kriteri lidhjeje, tashmë të një natyre më tepër teknike apo përllogaritëse se sa përmbajtësore, që është pikërisht mundësia e kompensimit ndërmjet tyre.

11. Për sa më sipër, niveli i koneksitetit mes padisë dhe kundërpadisë sipas dispozitave ligjore në fuqi, nuk kërkon domosdoshmërisht të qenit e tyre të së njëjtës natyrë nga pikëpamja lëndore.

12. Legjislatori shprehimisht dhe në mënyrë të vazhdueshme e ka parashikuar qartazi nivelin e ndërlidhjes së kërkuar mes padisë dhe kundërpadisë me qëllim shqyrtimin e tyre nga e



njëta gjykatë, që mund të jetë një lidhje e thjeshtë mes kërkimeve të secilës, pavarësisht natyrës lëndore të tyre apo një lidhje akoma më distante, siç është mundësia e thjeshtë e kompensimit mes kërkimeve përkatëse, ç'ka tregon se gjykata që shqyrton padinë është kompetente edhe për shqyrtimin e kundërpadisë, pavarësisht natyrës lëndore të kësaj të fundit.

13. Mendoj se konkluzioni i arritur nga shumica që një kundërpadi përveç kriterëve të mësipërme, duhet të plotësojë edhe kriterin e të qenit të së njëjtës natyre lëndore me padinë, në mënyrë që të shqyrtohet nga e njëjta gjykatë që shqyrton padinë, jo vetëm që bie ndesh me përmbajtjen e nenit 55 të Kodit të Procedurës Civile, por edhe nëse do të arrihej, do të përbente **një kriter shtesë**, i cili mund të kryhej vetëm nëpërmjet ndryshimeve përkatëse ligjore, e jo nëpërmjet një vendimi unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Ky i fundit, për nga vetë natyra, nuk mund të ketë efekt normimi *de novo*.

14. Kundër qëndrimit të shumicës së Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, mendoj se duke u nisur nga funksionet e Gjykatës së Lartë dhe pozicionimit të saj në sistemin gjyqësor shqiptar, sentenca unifikuese nxjerr në pah edhe probleme të dimensionit kushtetues.

14.1. *Së pari*, pikërisht për shkak të ndarjes së padisë nga kundërpadi sipas parashikimit të bërë në vendimin e mësipërm të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, evidentohet rreziku i dyfishtë i ndërhyrjes së palegjitimuar të Gjykatës së Lartë në pushtetin legjislativ, ku nga njëra anë gjykata, edhe pse në mungesë të prerogativave kushtetuese për të krijuar normë, prodhon ligj të ri dhe, nga ana tjetër, po kjo gjykatë, edhe pse në mungesë të së drejtës për të shfuqizuar normë, nulifikon përmbajtjen e nenit 55 të Kodit të Procedurës Civile.

14.2. *Së dyti*, për shkak të këtij qëndrimi unifikues identifikohen një sërë ndërlikimesh të natyrës ligjore dhe praktike që vënë në diskutim të drejtën kushtetuese të shtetasve për një proces të rregullt ligjor. Kjo e drejtë ka si pjesë integrale të saj gjykimin nga **një gjykatë e pavarur e caktuar me ligj**. Në zbatim të qëndrimit të shumicës në këtë vendim unifikues mbi gjykatën kompetente për shqyrtimin e kundërpadisë do të gjendeshim përpara rasteve ku neni 55 i Kodit të Procedurës

Civile do të bëhej i paaplikueshëm, pasi gjykata që shqyrton padinë kryesore nuk do të ishte kompetente për shqyrtimin e kundërpadisë, për sa kohë që kundërpadi nuk ka natyrë lëndore të njëjtë me padinë. Ndarja e padisë me kundërpadinë do të bënte që dy gjykata të ndryshme t'i shqyrtonin ato, pavarësisht përcaktimit kategorik ligjor të nenit 55 të Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon krejt të kundërtën. Krijimi i situatave të tilla ligjore në vetvete vë në dyshim të drejtën e shtetasve për gjykim nga një gjykatë e caktuar me ligj, e për rrjedhojë, vë në dyshim të drejtën e tyre për një proces të rregullt ligjor.

14.3. Për më tepër, procesi i rregullt ligjor kërkon respektimin e parimit të sigurisë juridike, i cili vihet në rrezik nga zbatimi i sentencës unifikuese mbi ndarjen e padisë nga kundërpadi, duke krijuar ekzistencën e procedurave gjyqësore paralele të shumta dhe të ndërlidhura, që kanë në thelb të njëjtën çështje ligjore. Një qëndrim i tillë bie ndesh me jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut mbi detyrimin e shteteve kontraktuese për të organizuar sistemin e tyre ligjor, me qëllim shmangien e procedurave të shumëfishta gjyqësore, të cilat duhet të mirë menaxhohen për të kontribuar në sqarimin e shpejtë të çështjes. Konkretisht në çështjen Mullai etj., kundër Shqipërisë, Gjykata e Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka arritur në konkluzionin se: “*..ekzistenca e procedurave gjyqësore paralele të shumta dhe të ndërlidhura duke shtruar në thelb të njëjtën çështje ligjore nuk mund të konsiderohet në përputhje me shtetin e së drejtës. Autoritetet shqiptare duke dhënë një sërë vendimesh kontradiktore në disa nivele të juridiksionit të tyre kanë demonstruar mangësi në sistemin gjyqësor, fakt për të cilin ato janë përgjegjëse*” (aplikimi nr. (9074/07), vendim i datës 23.3.2010).

15. Gjithashtu, procesi i rregullt ligjor kërkon përfundimin e një procesi brenda një afati të arsyeshëm kohor. Shqyrtimi në mënyrë të veçantë i padisë dhe i kundërpadisë, sipas qëndrimit të shumicës së Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, do të sillte pashmangshmërisht edhe tejzgjatjen e afateve kohore të nevojshme për gjykimin përfundimtar të tyre. Shpeshherë, pikërisht për shkak të koneksitetit, ndërlidhjes mes këtyre kërkimeve, dhënia e vendimit nga një gjykatë do të ishte e pamundur pa u përfunduar gjykimi paralel në gjykatën tjetër. Kjo e fundit në vetvete mbart rrezikun e kufizimit të së drejtës së shtetasve



për të pasur një gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor, si pjesë e së drejtës së tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.

16. Veç sa më sipër, mendoj se një ndërlikim praktik i sentencës unifikuese të shumicës së Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ka të bëjë me faktin se një kundërpadi e veçuar, e marrë për shqyrtim nga një gjykatë e ndryshme nga ajo që shqyrton padinë, nuk do të mund të konsiderohej më si kundërpadi, pasi mungon mjeti tjetër procedural korrespondues i nevojshëm për ekzistencën e tij, që është pikërisht padia. Kjo do të sillte për pasojë humbjen e kuptimit praktik dhe aplikueshmërisë së kundërpadisë për një numër të konsiderueshëm rastesh, pasi kundërpadia do të shndërrohej thjesht në padinë e mëvetshme të ngritur nga i padituri kundër paditësit në një proces të dytë, paralel gjyqësor.

Së fundmi, në vetvete kjo çon në mohimin e një mjeti procedural, të parashikuar nga Kodi i Procedurës Civile, për të paditurin në një proces gjyqësor, duke e detyruar njëkohësisht që të nisë një proces gjyqësor të mëvetshëm për të realizuar të drejtën e tij, e cila në thelb përbën të njëjtën çështje ligjore.

Anëtar: Mirela Fana

MENDIMI I PAKICËS

Si gjyqtarë në pakicë, kemi qëndrimin se Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk duhet të kishin disponuar prishjen e vendimit nr. 36, datë 5.2.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe dërgimin e çështjes për vazhdimin e gjyqimit në po atë gjykatë, me motivin që, meqenëse kundërpadia është paraqitur përpara datës 4.11.2013 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë dhe kjo gjykatë e ka pranuar për shqyrtim, gjyqimi i padisë civile dhe i kundërpadisë administrative do të vazhdojë të kryhet nga kjo gjykatë civile.

Përkundrazi, qëndrimi i pakicës është se Kolegjet e Bashkuara duhet të dispononin prishjen e vendimit nr. 36, datë 5.2.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim po asaj gjykate, mbi arsyetimin e kundërt me shumicën e Kolegjeve se, duke mos qenë kompetente për gjykimin e kundërpadisë me natyrë administrative dhe duke qenë se ende nuk e ka zgjidhur në themel çështjen lidhur me padinë e kundërpadinë, në seancë gjyqësore kjo gjykatë të

verifikonte aktet e dosjes gjyqësore, duke disponuar eventualisht mbajtjen për shqyrtim vetëm të padisë së rivendikimit që ka natyrë civile dhe dërgimin për shqyrtim të kundërpadisë pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për shkakun se kjo kundërpadi ka natyrë administrative dhe duhet të shqyrtohet nga kjo e fundit si gjykatë kompetente nga pikëpamja lëndore për mosmarrëveshjet administrative.

Ndonëse, në dukje, disponimi i shumicës së Kolegjeve është i njëjtë me atë të qëndrimit tonë si gjyqtarë në pakicë, duke qenë se çështja objekt shqyrtimi ka të bëjë posaçërisht me kompetencën e Gjykatës së Lartë për të zgjidhur mosmarrëveshjen e kompetencës lëndore ndërmjet gjykatës civile dhe asaj administrative, në thelb, qëndrimet e shumicës dhe pakicës mbi interpretimin dhe zbatimin e ligjit procedural, zgjidhjen e çështjes dhe motivin e prishjes së vendimit të gjykatës së shkallës së parë, sikurse parashtrohet më sipër, janë të kundërta me njëra-tjetrën.

Qëndrimi jonë i kundërt si gjyqtarë në pakicë në raport me shumicën e Kolegjeve të Bashkuara, edhe lidhur me zgjidhjen e mosmarrëveshjes për kompetencën në çështjen objekt gjyqimi, është rrjedhojë logjike e kuptimit dhe interpretimit tonë mbi parimet dhe dispozitat e Kushtetutës, ato të ligjit procedural civil dhe atyre të posaçme mbi gjykimin administrativ (ligji nr. 49/2012), kjo për sa i përket arsyetimit dhe përfundimeve unifikuese të ardhura nga shumica mbi çështjet e interpretimit dhe zbatimit të unifikuar ligjit të ngritura posaçërisht në pyetjen e dytë të parashtruar para këtyre Kolegjeve të Bashkuara.

Qëndrimi i gjyqtarëve në këtë mendim pakice, për sa i përket interpretimit dhe zbatimit të parimeve dhe normave kushtetuese, si edhe të atyre procedurale të gjyqimit civil e të atij administrativ, është i njëjtë dhe i shprehur plotësisht në arsyetimin e parashtruar dhe përfundimet unifikuese të ardhura nga shumica e Kolegjeve të Bashkuara, në pikat 6 deri 39 të vendimit unifikues, lidhur me çështjet e interpretimit të njëzuar të ligjit për pyetjen e parë që është shtruar për unifikim. Gjyqimi i padisë dhe kundërpadisë, do të bëhet, përkatësisht, vetëm nga gjykata që ka kompetencën lëndore sipas natyrës së mosmarrëveshjes. Pra, gjykata ku është paraqitur kundërpadia, do të mbajë për shqyrtim dhe do të vijojë gjykimin vetëm lidhur me padinë e për të cilën ajo e ka pasur



kompetencën lëndore (p.sh., civile), duke e dërguar kundërpadinë për shqyrtim në gjykatën tjetër (p.sh., administrative).

Të njëjtin qëndrim me shumicën e Kolegjeve, kemi edhe për sa i përket detyrimit të gjykatës së shkallës së parë që të verifikojë dhe të disponojë për mbajtjen për shqyrtim vetëm të kërtimeve të padisë që i përkasin kompetencës së saj lëndore (p.sh., civile), duke ia dërguar kërkimet e tjera të asaj padie gjykatës kompetente lëndore (p.sh., administrative).

Por, si gjyqtarë në pakicë, kemi mendim të kundërt me shumicën e Kolegjeve të Bashkuara lidhur me arsyetimin dhe përfundimet e ardhura prej saj për çështjet e interpretimit dhe zbatimit të unifikuar të ligjit të parashtruara në pyetjen e dytë, pra se si do veprohet në lidhje me kompetencën lëndore të gjykatës për shqyrtimin e kundërpadisë, në gjykimin në shkallë të parë, apel dhe Gjykatë të Lartë, lidhur me çështjet në të cilat kundërpadia është paraqitur para datës 4.11.2013.

Sipas parimeve dhe normave të njohura kushtetuese e ligjore, si edhe praktikës gjyqësore dhe jurisprudencës së konsoliduar, në gjykimin e mosmarrëveshjeve civile ose administrative zbatohet ligji procedural që është në fuqi në kohën e gjykimin. Përrjashtimisht, kur kjo parashikohet shprehimisht nga ligji me dispozitë kalimtare, gjen zbatim ligji i vjetër (i shfuqizuar) procedural apo përcaktohet shprehimisht nga ligjvënësi një zgjidhje e ndryshme, e posaçme, kalimtare.

Edhe në vendimin unifikues nr. 3, datë 6.12.2013, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së lartë, ndërmjet të tjerave janë shprehur se:

“.....Zbatimi i ligjit procedural lidhet me momentin kur zhvillohet gjykimi për shqyrtimin e mosmarrëveshjes para gjykatës. Nëse gjatë shqyrtimit gjyqësor të një çështjeje, ligji procedural ndryshon, atëherë në gjykim do të zbatohet ligji i ri, me përjashtim të rastit kur vetë ky ligj në dispozitat kalimtare ka parashikuar që për njëfarë kobe ose rrethana të caktuara, të vazhdojë zbatimi i ligjit të vjetër procedural.....

..... edhe praktika e Gjykatës Kushtetuese, e cila është shprehur vazhdimisht për kushtetutshmërinë e një procesi duke theksuar, se në të drejtën procedurale ndryshe nga ajo materiale, ligji i ri ka fuqi edhe për çështjet që janë në gjykim, me përjashtim të rastit kur vetë ai shprehet ndryshe duke parashikuar dispozitë procedurale kalimtare. (Shtih vendimin nr. 106/2002; nr. 11/2009 të Gjykatës Kushtetuese)....

.... është vetë ligjvënësi i cili duhet të shprehet se nuk do të zbatohet ligji i ri procedural, por ai i vjetri, gjë që do të thotë se vetë ligji i ri duhet të ketë të përcaktuar qartë se në lidhje me çfarë problemesh dhe deri në çfarë afati kohor do të vazhdojë të zbatohet ligji i vjetër procedural dhe jo ai që është në fuqi....

....fakti që ligji nr. 49/2012 është ligj procedural dhe nuk përmban dispozitë kalimtare që të tregojnë se cila është gjendja, faza apo shkalla e gjykimin të një mosmarrëveshjeje gjyqësore mbi të cilën ky ligj i shtrinë efektet, atëherë rrjedhimisht pranohet se duke filluar nga data 4.11.2013, ky ligj është i zbatueshëm për të gjitha çështjet që vetë ai i ka përcaktuar si mosmarrëveshje administrative, pavarësisht në çfarë gjendjeje, faze apo shkallë ndodhet gjykimi....

....Ligji nr. 49/2012 parashikon jo vetëm krijimin e gjykatës së posaçme për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, por edhe parime të ndryshme procedurale mbi bazën e të cilave do të zgjidhen këto mosmarrëveshje.”.

Pavarësisht nga këto parime të njohura dhe qëndrimet e mbajtura në praktikën e tyre të unifikuar, shumica e Kolegjeve të Bashkuara në çështjen objekt shqyrtimi, mban qëndrim të kundërt në lidhje me ligjin procedural të zbatueshëm në kohë për sa i përket kompetencës për gjykimin, bashkërisht ose të ndarë, të padisë civile dhe kundërpadisë administrative apo anasjelltas për çështjet në të cilat padia me kërkitime të përziera ose kundërpadia është paraqitur dhe është pranuar për shqyrtim përpara datës 4.11.2013.

Këtë qëndrim të saj shumica e Kolegjeve të Bashkuara e mbështet në arsyetime, të cilat, në thelb, nuk kanë të bëjnë me interpretimin e drejtë të ligjit bazuar në parimet dhe normat themeltare të Kushtetutës, të KEDNJ-së dhe ligjeve të tjera, por janë arsyetime që lidhen me gjykimin kushtetues, posaçërisht me atë të vlerësimit të pajtueshmërisë së parashikimeve të dispozitave ligjore me parimet dhe normat kushtetuese. Ky lloj gjykimi dhe arsyetimi, duke qenë i natyrës kushtetuese, i përket juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese, ndërkohë që, gjykatat e tjera, nëse çmojnë se ligji nuk pajtohet me Kushtetutën, i drejtohen Gjykatës Kushtetuese, për të vendosur për kushtetutshmërinë e ligjit dhe të normave përkatëse.

Pra, shumica e Kolegjeve të Bashkuara, duke aplikuar gabimisht elemente të gjykimin kushtetues mbi shqyrtimin e kushtetutshmërisë së normës së ligjit abstrakt që i përket



ekskluzivisht Gjykatës Kushtetuese, vijnë arsyetimin e tyre dhe vijnë në përfundimin se zbatimi vetëm i parimit kushtetues të gjykatës së caktuar me ligj (për të cilat vetë këto Kolegje mbajtën qëndrimin se obligojnë gjykimin e veçuar të kërkimeve, të padisë e kundërpadisë nga gjykata civile ose administrative sipas kompetencës lëndore), vetëm për çështjet që janë në gjykim në shkallë të parë përpara datës 4.11.2013, do të cenonte parimin e sigurisë juridike, atë të pritshmërive të ligjshme të individëve nga rendi juridik në fuqi, të ekonomisë gjyqësore, të gjykimit të çështjes në një afat të arsyeshëm etj. Prandaj, sipas shumicës së Kolegjeve, gjykimi i këtyre çështjeve do të vazhdojë nga gjykata e zakonshme (civile), ku edhe janë paraqitur padia me kërkime të përziera apo edhe kundërpadia, me kusht që kjo të ketë ndodhur përpara datës 4.11.2013.

Gjykime, qëndrime dhe interpretime që, në thelb, nuk i përkasin gjykimit të zakonshëm, por vetëm atij kushtetues, shumica parashtron, ndërmjet të tjerave, në pikën 43 të vendimit kur shprehen se: *“.....Situata faktike e çështjeve në të cilat kërkimet në padi ose kundërpadi janë paraqitur përpara datës 4.11.2013, të cilat janë në gjykim e sipër nëpër gjykata, është e tillë që këto gjykime mund të jenë në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, gjykimi i tyre edhe mund të ketë përfunduar në shkallë të parë dhe mund të jenë duke u gjykuar në shkallë të tjera. Duhet pasur parasysh se janë të shumta çështjet e tilla në të cilat padia ka disa kërkime, të tilla që në kuptim të përcaktimit të kompetencës lëndore, pas datës 4.11.2013, u përkasin gjykatave të ndryshme. Në të tilla kushte, ndarja e këtyre çështjeve me arsyetimin se gjykata ku janë paraqitur nuk është kompetente për vazhdimin e shqyrtimit të gjitha kërkimeve, do të paraqiste një sërë problematikash. Në të njëjtën kohë nuk do t'i shërbente as interesave të drejtësisë dhe të qytetarëve, në drejtim të dhënies së një vendimi brenda një afati të arsyeshëm kohor...”*.

Po kështu, edhe në pikën 47: *“Vonesat që sjell ndarja e kërkimeve të natyrave të ndryshme në një çështje, cenojnë stabilitetin dhe sigurinë e marrëdhënieve juridike në mes të subjekteve të së drejtës. Nga ana tjetër, ato kufizojnë të drejtën e shtetasve për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm, si pjesë e të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Në kuadër të KEDNJ-së, është detyrim i shteteve garantimi i afatit të arsyeshëm kohor të gjykimit të një çështje, me qëllim mbrojtjen të gjitha palëve*

ndërgjyqëse nga vonesat e gjata procedurale dhe dhënien fund të pasigurisë së interesave të shtetasve.”

Edhe referenca e treguar në pikën 48 të vendimit, për mbështetjen e arsyetimit të shumicës së Kolegjeve të Bashkuara në vendimet nr. 2/2013 dhe nr. 9/2007 të Gjykatës Kushtetuese, në të vërtetë tregon se Gjykata Kushtetuese është shprehur aty jo për mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit nga gjykatat, por i adresohet ligjvënësit, pikërisht lidhur me parimet kushtetuese që ligjvënësi duhet të mbajë parasysh kur harton dhe miraton ligje të reja që synojnë të kufizojnë të drejtat e njohura dhe fituara më parë me ligj nga subjektet përfituese.

Si gjyqtarë në pakicë kemi qëndrimin se, shumica e Kolegjeve të Bashkuara, duke arsyetuar në këtë mënyrë, gjendet në kundërshtim me vetë qëndrimet e saj të qarta e korrekte për interpretimin e ligjit procedural në përgjigje të pyetjes së parë unifikuese, si edhe pa u shprehur haptazi se gjendet eventualisht para ndonjë lloji ometimi kushtetues (si p.sh. mungesës së dispozitave kalimtare që do të mënjanonin cenimin e parimit kushtetues të sigurisë juridike, të pritshmërive të ligjshme të individëve nga rendi juridik në fuqi, të ekonomisë gjyqësore, të gjykimit të çështjes në një afat të arsyeshëm etj., lidhur me gjykimin e kërkimeve dhe padive e kundërpadive të përziera civile e administrative). Kjo qasje e sjell praktikisht shumicën e Kolegjeve të Bashkuara në orientimin që, për çështjet që kanë qenë në gjykim në shkallë të parë përpara datës 4.11.2013 dhe gjykimi në atë shkallë ende nuk ka përfunduar, gjykatat civile të mos mbajnë parasysh që ligjvënësi nuk ka vlerësuar të miratojë një dispozitë kalimtare që lejon zbatimin e normës së vjetër procedurale apo që të lejojë zgjidhjen që përcakton shumica e Kolegjeve, pra që gjykata civile të vijnë të shqyrtojë çështjen me padi civile e kundërpadi administrative, edhe pse ajo nuk ka kompetencë lëndore për kundërpadinë.

Por, sipas mendimit të gjyqtarëve në pakicë, problematikat, vështirësitë apo vonesat që shumica e Kolegjeve të Bashkuara parashikojnë se mund të ndodhin në gjykimin e çështjeve me padi e kundërpadi, si edhe me kërkime të përziera, civile dhe administrative, nëse ato mund të ndodhin, janë të një natyre që nuk ka të bëjë me interpretimin e ligjit, por me zgjidhjet që ka parashikuar vetë ligji apo me ometimet e ligjit, për të cilat, nëse do të pranohej se ekzistonin sikurse parashtron shumica,



rrugët e vetme do të ishte ose ajo e investimit të Gjykatës Kushtetuese për t'u shprehur mbi kushtetutshmërinë e normës ose investimi i ligjvënësit për të bërë shtesa dhe ndryshime me legjislacionin ekzistues.

Gjykata e Lartë është gjykatë ligji. Si çdo gjykatë tjetër, ajo mbështet në vendimet e dhëna prej saj në Kushtetutë dhe në ligj, duke pasur pra të drejtën dhe detyrimin vetëm që të interpretojë dhe të zbatojë normat kushtetuese e ligjore në zgjidhjen e çështjes. Në këtë kuptim, gjykatat kanë të drejtën e detyrimin të interpretojnë dhe të arsyetojnë bazuar në normat kushtetuese dhe ligjore në funksion të zgjidhjes së çështjes, por ato nuk mund të injorojnë a refuzojnë të zbatojnë ligjin procedural nëse kanë qëndrimin se ai ligj vjen në kundërshtim me Kushtetutën apo me motivin e mungesës së parashikimit të shprehur të një rregullimi ligjor procedural të caktuar. Gjykatat nuk bëjnë gjykim kushtetues mbi ligjin abstrakt. Në raste të tilla, sikurse parashikon pika 2, e nenit 145, të Kushtetutës "Kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, nuk i zbatojnë ato. Në këtë rast, ata pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen Gjykatës Kushtetuese". Pra, vetëm gjykatat mbajnë qëndrimin e tyre duke parashtruar arsyet përse mendojnë se një dispozitë ligjore nuk është në përputhje me Kushtetutën dhe përse nuk mund ta zgjidhin çështjen pa u shprehur më parë Gjykata Kushtetuese lidhur me kushtetutshmërinë e asaj norme juridike të ligjit të zbatueshëm për zgjidhjen e çështjes që ka për shqyrtim.

Prandaj, në përgjigje të pyetjes së dytë të shtruar për unifikim të praktikës gjyqësore, si gjyqtarë në pakicë kemi qëndrimin se, **si për çështjet që kanë filluar të gjykohen përpara datës 4.11.2013 apo edhe pas kësaj date dhe që janë ende në shqyrtim pranë gjykatave civile ose administrative të shkallës së parë, këto gjykata duhet të disponojnë mbajtjen për gjykim të kërkimeve të padisë dhe kundërpadisë që janë në kompetencën e tyre lëndore, duke i dërguar për kompetencë kërkimet e tjera gjykatës që i ka ato në kompetencë lëndore sipas ligjit.**

Disponimi lidhur me mbajtjen në kompetencë për gjykim të kërkimeve të padisë, të padisë apo kundërpadisë për një pjesë të së cilave gjykata ku janë paraqitur ka kompetencën lëndore, duke ia dërguar kërkimet e tjera gjykatës tjetër që ka

kompetencën lëndore, janë disponime që mund të bëhen vetëm gjatë gjykimit të çështjes në shkallë të parë.

Prandaj, për çështjet gjyqësore, me kërkime, padë e kundërpadi, një pjesë e të cilave janë civile dhe pjesa tjetër administrative, të cilat gjenden për shqyrtim në gjykatën e shkallës së dytë, ato duhet të vijojnë të gjykohen nga gjykata e apelit në të cilat është paraqitur ankimi kundër vendimit gjyqësor të themelit të gjykatës së shkallës së parë. Në këto raste, nuk ka më asnjë mbështetje juridike që kërkimet e padisë (apo kundërpadisë, nëse ka të tillë), sipas natyrës civile ose administrative të tyre, nga gjykata e apelit dhe gjykata administrative e apelit, të gjykohen duke mbajtur për shqyrtim një pjesë të tyre dhe dërguar për kompetencë pjesën tjetër të kërkimeve, sipas kompetencës lëndore përkatëse. Përfundimisht, nëse gjykata e shkallës së dytë disponon prishjen e vendimit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim, çështja i dërgohet një trupe tjetër gjyqësore të gjykatës së shkallës së parë që nga pikëpamja lëndore kishte dhënë vendimin gjyqësor të cenuar. Në këtë gjendje të procedimit, kjo gjykatë e shkallës së parë duhet të investohet për të verifikuar dhe disponuar eventualisht lidhur me kërkimet që duhet të mbajë për shqyrtim si gjykata kompetente, duke ia dërguar kërkimet e tjera për shqyrtim gjykatës tjetër që ka kompetencën lidhur me to.

Si gjyqtarë në pakicë, kemi mendimin se i njëjti qëndrim duhet të mbahet edhe lidhur me çështjet që i janë paraqitur për shqyrtim Gjykatës së Lartë, ku kolegji kompetent për shqyrtimin e rekursit do të ishte ai kolegji që mbulon lëndën gjyqësore që i përket gjykatës së apelit që ka dhënë vendimin e kundërshtuar me anë të rekursit.

Për sa i përket zgjidhjes së çështjes objekt i këtij gjykimi, sikurse parashtrorjmë në fillim të këtij mendimi pakice, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë duhet të dispononin prishjen e vendimit nr. 36, datë 5.2.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim po asaj gjykate. Në thelb, me arsyetim të kundërt me shumicën e Kolegjeve se, duke mos qenë kompetente për gjykimin e kundërpadisë me natyrë administrative dhe duke qenë se ende nuk e



ka zgjidhur në themel çështjen lidhur me padinë e kundërpadinë, në seancë gjyqësore kjo gjykatë të verifikojë aktet e dosjes gjyqësore, dhe të disponojë mbajtjen për shqyrtim vetëm të padisë së rivendikimit që ka natyrë civile dhe të dërgonte për shqyrtim kundërpadinë pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për shkakun se kjo kundërpadi ka natyrë administrative

dhe duhet të shqyrtohet nga kjo e fundit si gjykatë kompetente nga pikëpamja lëndore për mosmarrëveshjet administrative.

Anëtarë: Arjana Fullani, Ardian Nuni, Ardian Dvorani, Artan Zeneli, Evelina Qirjako, Aleksandër Muskaj

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 04 2427005, 04 2427006

Çmimi 224 lekë